



2019
RAPORTI VJETOR

Përmbajtja

Mesazhi nga Bordi i Drejtorëve.....	4-5
Mesazhi nga Kryeshefi Ekzekutiv.....	6
Struktura organizative e bankës.....	10
Vizioni.....	11
Misioni.....	11
Vlerat tona.....	11
Banka Ekonomike – Një rrëfim suksesi.....	12
Mjedisi makroekonomik.....	13
Sektori bankar.....	14
Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës.....	15
Pjesëmarrja në kredi.....	16
Pjesëmarrja në depozita.....	17
Pasqyra e pozicionit financiar.....	18-19
Performanca e Bankës Ekonomike.....	20
Asetet e bankës.....	20
Ecuria e kreative.....	21
Ecuria e depozitave.....	22
Zhvillimi i biznesit.....	25
Gjithsej kreditë.....	26
Klientët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.....	26
Klientët korporatë.....	27
Klientët individualë.....	28
Klientët e lizingut.....	29
Përgjegjësia shoqërore korporative.....	29
Mbështetja për sportin.....	30
Veprimtaria sociale.....	31
Mbështetja për gratë ndërmarrëse.....	32
Kanalet e distribuimit.....	33
Kanalet alternative të distribuimit.....	34
Kujdesi ndaj klientëve.....	36
Menaxhimi i rrezikut.....	37

Rreziku kreditor.....	38
Rreziku operacional.....	39
Rreziku i likuiditetit dhe tregut.....	40
Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.....	41
Operacionet dhe pagesat.....	41
Transferet kombëtare.....	42
Transferet ndërkombëtare.....	43
Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare.....	44
Kartelat bankare.....	45
Teknologjia e informacionit.....	46
Menaxhimi dhe trajnimi i personelit.....	46
Pajtueshmëria e përgjithshme.....	47
Rrugëtimi vazhdon.....	48

Mesazhi nga Bordi i Drejtorëve


Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Viti 2019 ka qenë vit transformues për Bankën Ekonomike në caktimin dhe adaptimin e objektivave afatgjate afariste të bankës. Në bazë të strategjisë së aprovuar, banka është përqëndruar dhe ka investuar resurse të nevojshme në zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve të reja në pajtueshmëri me nevojat e klientëve tanë. Investime të konsiderueshme janë bërë poashtu në digjitalizimin dhe modernizim e infrastrukturës për të mundësuar transformimin e modelit të operimit të Bankës dhe përmirësimin e performancës.

Në aspektin e rezultateve dhe indikatorëve financiar, Bordi Drejtues ka kënaqësinë të prezantoj rezultatet pozitive të arritura nga Banka Ekonomike për vitin 2019. Rezultatet e arritura tregojnë rritjen e performancës së Bankës Ekonomike dhe aftësinë e punonjësve tanë për të zbatuar strategjinë me efikasitet në një treg shumë konkurrues dhe sfidues.

Bordi Drejtues kryen detyrat që janë të përcaktuara me ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, si dhe kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative.

Bordi Drejtues gjatë vitit 2019 ka mbajtur takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas nevojës, në mënyrë që të përcjellin mbikëqyrjen e politikave dhe zbatimin e strategjisë së bankës. Gjithashtu, në takimet e Bordit Drejtues është diskutuar dhe vendosur për tema të tjera që lidhen me menaxhimin në përgjithësi, kulturën korporative në bankë, koordinimin dhe kontrollin, sistemet e pajtueshmërisë dhe kompensimit. Neve si Bord Drejtues na është raportuar në baza të rregullta për zhvillimin e biznesit, zhvillimin financiar, pasqyrat financiare, rrezikun e bankës, likuiditetin dhe administrimin e kapitalit, burimet e duhura teknike dhe organizative si dhe çështjet e tjera me rëndësi për bankën. Si Bord Drejtues në bashkëpunim me Ekzekutivin dhe Menaxhmentin e Lartë kemi miratuar politika dhe vendime me rëndësi thelbësore për bankën.



Në takimet e Bordit Drejtues i është dhënë hapësira e duhur departamentit të pajtueshmërisë së përgjithshme si funksion raportues direkt tek Bordi Drejtues, me qëllim të adresimit të kërkesave të reja rregullative, trajtimit të rasteve për parandalim të mashtrimeve dhe zbatimit të kodit të mirësjelljes.

Gjithashtu, si funksion tjetër raportues direkt tek Bordi Drejtues vëmendje të veçantë i është dhënë edhe departamentit të pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parave ku është diskutuar për statusin dhe zhvillimet në këtë departament, si dhe automatizimi i proceseve dhe pjesa e menaxhimit të procesit “KYC – know your client”.

Komiteti i Auditimit – Si komitet i veçantë, ka raportuar në baza të rregullta në mbledhjet e Bordit Drejtues duke adresuar çështje të ndryshme sipas raporteve të auditimeve që janë bërë në periudhat e raportimit. Këto raporte janë trajtuar me seriozitetin më të lartë me qëllim që proceset e bankës të përmirësohen në vazhdimësi.

Komiteti i menaxhimit të riskut - ka mbajtur takime të rregullta me agjenda përkatëse sipas rregulloreve në fuqi. Zyrtari kryesor i riskut ka raportuar dhe ka përpiluar strategjitë dhe politikat e menaxhimit të riskut të bankës dhe të njëjtat me këshillim me komitetin për menaxhimin e riskut, janë shqyrtuar dhe aprovuar në takimet e Bordit Drejtues.

Komiteti i qeverisjes korporative, personelit dhe kompensimit - ka adresuar çështjet që lidhen me zbatimin e kërkesave të qeverisjes korporative si dhe politikat e personelit dhe politikat e kompensimit duke krijuar praktika të mira të menaxhimit të personelit, trajtimit dhe motivimit të tyre.

Komiteti i teknologjisë informative – ky komitet është krijuar nga ana e Bordit Drejtues duke e vlerësuar rritjen dhe ndryshimet teknologjike globale dhe me qëllim që të adresohen çështjet e ndërlidhura me teknologjinë informative dhe sigurinë e informacionit.

Bordi Drejtues falënderon të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike për përkushtimin dhe arritjen e objektivave të caktuara për vitin 2019. Një faleminderim i posaçëm i drejtohet klientëve dhe aksionareve tanë për mbështetjen dhe besimin e dhënë.

Në emër të Bordit të Drejtorëve
Shpend Luzha
Kryesues



Mesazhi nga Kryeshefi Ekzekutiv

Të nderuar kolegë, klientë dhe aksionarë të Bankës Ekonomike,

Në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv të Bankës Ekonomike, kam kënaqësinë e veçantë të ndaj me ju vitin më të suksesshëm të Bankës Ekonomike, që nga themelimi i saj. Një sukses si ky, natyrisht se nuk do të mund të arrihej pa një ekip profesionistësh, të mrekullueshëm, të cilin e kemi ndërtuar së bashku, pa klientët tanë besnikë dhe pa mbështetjen e pa rezervë të aksionarëve dhe te bordit drejtues të Bankës Ekonomike, andaj dua të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim më të lartë për të gjithë ju.

Objektivat që i kishim përcaktuar ishin mjaft sfiduese dhe kërkonin një dinamikë dhe angazhim të jashtëzakonshëm të secilit nga ne, por, me angazhimin e jashtëzakonshëm të të gjithëve i'a dolëm.

Mjedisi makro-ekonomik në Kosovë vazhdon të jetë më i mirë se në shumë vende të Evropës Juglindore, me një rritje të bruto produktit vendor rreth 4.2 përqind, duke kontribuar kështu në rritje ekonomike dhe stabilitet financiar.

5.95 milionë euro është fitimi para tatimit i Bankës Ekonomike për vitin 2019, shifra këto më të lartat deri më sot. Me një qasje të matur dhe të arsyeshme, kemi rritur numrin e kredive në të gjitha segmentet, duke rritur portfolion tonë kreditore për 37.6 milionë euro, duke shënuar rritje prej 21.1 përqind. Si rezultat i qasjes sonë

të kujdesshme dhe shërbimit të nivelit më të lartë të klientëve, kemi arritur rezultate të konsiderueshme edhe në cilësinë e portfolios sonë, duke ulur nivelin e kredive joperformuese në më të ulët në vitet, 2.31 përqind.

Një tjetër drejtim në të cilin kemi punuar kujdesshëm janë depozitat, të cilat arritën nivelin më të lartë ndonjëherë, në 284.8 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 13.8 përqind. Kjo rritje në depozita është një shembull i qartë i besimit që klientët kanë në Bankën Ekonomike dhe kënaqshmërinë e tyre me produktet dhe shërbimet tona. Rreziku ndaj likuiditetit është trajtuar me kujdes të shtuar, ku raporti në mes ekspozimeve kreditore dhe depozitave është në nivelin 75.75 përqind.

Viti 2019 ka qenë vit i zhvillimit dhe avancimit shumëdimensional për Bankën Ekonomike. Përveç performancës financiare, ne kemi shënuar edhe shumë arritje të tjera, siç është përmirësimi i mëtejshëm i procesit të shërbimit ndaj klientëve tanë - në këtë drejtim kemi themeluar shërbimin për klientët VIP, ku klientët e kësaj kategorie do të kenë pako të veçantë të shërbimeve me të gjitha produktet dhe shërbimet bankare. Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit të degëve dhe hapësirave vetëshërbyese, kemi ridizajnuar degën në Prishtinë, nëndegën në Kaçanik, kemi rialokuar degën në Ferizaj dhe qendrën e biznesit në Prishtinë e cila tashmë ofron një nga ambientet më moderne në industrinë bankare për shërbim të klientëve: individë, VIP, mikro, agro, lizing dhe korporatë. Gjithashtu, kemi hapur nëndegën e re në Obiliq.

Projekte dhe iniciativa të shumta janë ndërmarrë dhe realizuar gjatë këtij viti. Po i veçoj vetëm disa nga to: IT outsourcing, implementimi i suksesshëm i office 365, ofrimi i suksesshëm i kartelave contactless, iniciativë dhe dokumentim të proceseve në drejtim të ndërrimit të sistemit themelor bankar dhe shumë projekte e iniciativa tjera.

Fatos Krasniqi
Kryeshef Ekzekutiv




Hamide Pacolli Gashi
Zv. Kryeshefe Ekzekutive




Arijan Haxhibeqiri
Zv. Kryeshef Ekzekutiv


Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit




Asetet (në milionë EURO)




Kreditë (në milionë EURO)




Depozitat (në milionë EURO)




Kreditë joperformuese (KJP)



Fitimi para tatimit (në milionë EURO)





Vizioni

Bankë e orientuar në rritje të qëndrueshme dhe kualitative, shërbime cilësore dhe standarde të larta profesionale.

Misioni

- Profilizimi si bankë e klientëve individual dhe NVM nëpërmjet modelit të biznesit, gamës së produkteve dhe shërbimeve si dhe strategjisë së marketingut
- Ofrimin e shërbimeve me dizajn specifik për klientin nëpërmjet koncepteve si VIP, Lizing dhe Agro Biznes
- Bankë për zhvillim profesional të stafit nëpërmjet programeve të trajnimit, planifikimit dhe orientimit të karrierës
- Ofrim të shërbimeve 24/7 nëpërmjet kanaleve alternative në një ambient dhe dizajn të sofistikuar
- Digjitalizimi i shërbimeve financiare dhe proceseve nëpërmjet avancimit teknologjik

Vlerat tona

Ne karakterizohemi nga PUNA EKIPORE, përmes së cilës i përmbushim nevojat e klientëve tanë. Puna ekipore na sjellë respekt të ndërsjellë, marrëdhënie më të mira ndër njerëzore dhe fuqizim drejt arritjes së objektivave tona të përbashkëta. Ne karakterizohemi nga RESPEKTI për njëri tjetrin dhe RESPEKTI për klientët. Ne karakterizohemi dhe jemi të angazhuar për standarde të larta ETIKE dhe profesionale, duke demonstruar sjellje të ndershme, profesionale dhe etike në marrëdhëniet tona me kolegët, klientët dhe shoqërinë.



Banka Ekonomike një rrëfim sukcesi

Banka Ekonomike u licencua në vitin 2001 kur edhe filloi operimin si banka e vetme me kapital 100 përqind vendor. Duke qenë Banka Ekonomike e vetme me kapital tërësisht vendor, misioni ynë merrte një dimension edhe më të rëndësishëm sepse përmes sigurimit të një shërbimi të nivelit më të lartë, ne dëshironim të jepnim shembull se këtë gjë mund t'a arrinte edhe një institucion financiar i themeluar tërësisht nga vendi. Sot, gati dy dekada më vonë, me krenari mund të themi se jo vetëm që e kemi arritur këtë objektiv, por në shumë fusha edhe e kemi tejkaluar. Një ndër asetet kryesore të bankës janë 339 punonjësit tanë që dallohen për nga kualifikimi dhe trajnimet e tyre profesionale të vazhdueshme me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre sa më të mirë ndaj klientëve dhe bankës. Rezultatet e shkëlqyeshme na shtojnë që t'u kushtojmë rëndësi edhe më të madhe trajnimeve dhe avancimit të vazhdueshëm të stafit. Për të qenë sa më të qasshëm për klientët dhe duke i përcjellur kërkesat e tregut, Banka Ekonomike edhe gjatë këtij viti i kushtoi vëmendje të veçantë përmirësimit të kanaleve të distribuimit; gjegjësisht rrjetit të degëve, qendrës së thirrjeve, bankomatëve (ATM), kartelave bankare, pikave të shitjes (POS) dhe kujdesit ndaj klientit. Me qëllim të krijimit të një imazhi dhe pranie të fuqishme në treg, Banka Ekonomike ka arritur një shtrirje të degëve në gjithë territorin e Kosovës. Gjatë vitit 2019, Banka Ekonomike ka operuar gjithsej me 31 degë të cilat janë të ndara në 7 rajone kryesore në kuadër të të cilave operojnë 24 nëndegë, duke qenë kështu sa më afër klientit. Ndërsa numri i punëtorëve gjatë vitit 2019 ka qenë 339.

Përmirësimi i mëtejshëm i procesit të shërbimit për klientët tanë secilin vit trajtohet me fokus të veçantë, në këtë drejtim gjatë vitit 2019 Banka Ekonomike ka ridizajnuar degën në Prishtinë, nëndegën në Kaçanik, kemi rialokuar degën në Ferizaj dhe qendrën e biznesit në Prishtinë, e cila tashmë ofron një nga ambientet më moderne në industrinë bankare për shërbim të klientëve. Gjithashtu, me qëllim të jemi sa më afër klientëve, në vitin 2019 kemi hapur nëndegën e re në Obiliq.

Banka Ekonomike beson fuqishëm që duke përkrahur aktivitete dhe kauza të grupeve të ndryshme sipas nevojës kontribuon në mirëqenien shoqërore dhe se rezultatet pozitive reflektojnë pozitivisht edhe te Banka.



Mjedisi makroekonomik

Ekonomia e Eurozonës ka shënuar rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik përgjatë gjithë vitit 2019. Vetëm në TM4 2019, sipas të dhënave preliminare të Eurostatit, aktiviteti ekonomik shënoi rritje prej 1.0 përqind. Në linjë me aktivitetin e ngadalësuar ekonomik ka lëvizur edhe trendi i inflacionit (1.0 përqind). Ndërsa, në vendet e ballkanit perëndimor, rritja e aktivitetit ekonomik prej 4.3 përqind në TM3 2019 ishte e ngjashme me TM3 2018. Sipas vlerësimeve të Agjencisë së statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale deri në shtator 2019 shënoi rritje mesatare vjetore prej 4.3 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga përmirësimet e eksporteve neto.

Çmimet e konsumit deri në dhjetor 2019 janë rritur për 2.7 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë shënoi rritje prej vetëm 0.3 përqind apo 2.3 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Spektori fiskal në vitin 2019 u karakterizua me rritje të të hyrave buxhetore prej 7.5 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 7.2 përqind. Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 168.4 milionë euro (162.7 milionë euro deficit në vitin 2018).

Si përqindje e BPV-së deficiti primar buxhetor ishte 2.3 përqind (2.4 përqind në vitin 2018). Borxhi publik në fund të vitit 2019 ka arritur në 1.2 miliardë euro, që është për 9.9 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.5 përqind nga 17.1 përqind sa ishte në vitin 2018.

Spektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 23.0 përqind. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa deficitit i mallrave shënoj rritje të ngadalësuar.

Sistemi financiar gjatë TM4 2019 shënoi rritje për 243.2 milionë euro në asete, rritje që i atribuohet kryesisht sektorit bankar dhe atij pensional.

Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike

Sektori bankar

Zgjerimi i aktivitetit të sistemit financiar në 2019 u mundësua kryesisht nga sektori bankar dhe ai pensional, që njëkohësisht kanë dhe peshën më të madhe në gjithsej asetet e sistemit. Sektori bankar në 2019 u zgjerua duke u mbështetur kryesisht nga niveli i lartë i depozitave të arkëtuara, të cilat janë burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditor. Gjatë 2019, kreditimi për korporatat jo financiare shënoi rritje më të theksuar krahasuar me kreditimin ndaj ekonomive familjare. Edhe gjatë 2019, performanca e sektorit bankar ishte e kënaqshme, duke gjeneruar fitim neto në vlerë prej 89.7 milionë euro. Mirëpo, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sektori bankar ka shënuar rënie të profitit si rezultat i rënies së të hyrave (kryesisht nga jo interesi), përderisa niveli i shpenzimeve ka mbetur pothuajse i njëjtë. Treguesit e cilësisë të portfolios kreditorë në fund të vitit 2019 ishin në nivele të kënaqshme, me nivel të ulët të kredive joperformuese dhe rritje të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Për më shumë, edhe indikatorët e solvencës dhe likuiditetit janë mbi nivelet minimale të rekomanduara me rregullore, që janë indikacion për një treg mirë të kapitalizuar dhe likuid.

Asetet e sektorit bankar gjatë 2019 arritën vlerën prej 4.75 miliardë euro në fund të periudhës. Kjo rritje u mundësua kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit kreditor, që përbën rreth 64 përqind të aseteve të sektorit bankar. Në baza vjetore, kategoria e kredive u zgjerua për 253 milionë euro, vlerë kjo pak më e lartë krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Aktiviteti i sektorit bankar është i mbështetur nga depozitat në nivelin prej 79.6 përqind. Gjithsej depozitat u rritën për 16.2 përqind, dhe arritën nivelin prej 3.91 miliardë euro, ndikuar kryesisht nga depozitat e transferueshme të ekonomive familjare. Depozitat e ekonomive familjare, që përbëjnë sektorin e jashtëm, rreth 90 përqind janë me bankat e huaja. Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën 2.60 miliardë euro në fund të periudhës ndërsa depozitat e korporatave jofinanciare në bazë të rritjes arritën vlerën prej 747.6 milionë euro në fund të periudhës.

Kreditë jo-performuese në fund të dhjetorit 2019 shënuan rënie prej 16.0 përqind krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në 2.0 përqind. Ky nivel i KJP-ve është më i ulëti deri tani, dhe përcillet nga një mbulueshmëri e kënaqshme e tyre me provizione.

Burimi:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Raporti i Stabilitetit Financiar dhe Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar

Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës

Në vitin 2019, Banka Ekonomike ka arritur t'a ruajë pozicionin e saj në treg, duke përcjellur trendin e tregut bankar, i cili vazhdon të shënojë rritje. Rritja e tregut bankar në të gjitha asetet prej 14.32 përqind është ndjekur nga afër edhe nga Banka Ekonomike, e cila ka shënuar rritje në të gjitha asetet prej 13.78 përqind.

Në numra realë, në fund të vitit 2019, pasuritë/asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike u rritën në 322.5 milionë euro krahasuar me 281.1 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2018.

Pjesëmarrja në kredi

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total kreditë në treg, më datën 31 dhjetor 2019, ka qenë 7.16 përqind e sektorit të përgjithshëm bankar.

% në volumet e kredive




Figura 1: Pjesëmarrja e bankave në kreditë e përgjithshme, 31 dhjetor 2019

Pjesëmarrja në depozita

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total depozitat në treg, me datën 31 dhjetor 2019, ka qenë 7.36 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë.

% në volumet e depozitave




Figura 2: Pjesëmarrja e bankave në depozita, 31 dhjetor 2019

Pasqyra e pozicionit financiar

Bilanci i gjendjes me: 31.12.2019	Euro '000
Pasuritë	Tremujori vijues 31/12/2019
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	51,990
Kërkesat ndaj bankave	14,163
Bonot e thesarit	5,218
Investimet në letra me vlerë	29,883
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	208,570
Patundshmëritë dhe pajisjet	9,925
Pasuritë e paprekshme	565
Pasuritë tatimore, të shtyra	0
Pasuritë tjera	2,187
Gjithsej pasuritë	322,501
Detyrimet	
Depozitat e klientëve	282,682
Detyrimet ndaj bankave	2,100
Fondet tjera të huazuara	1,050
Detyrimet tatimore, të shtyra	151
Detyrimet tjera	3,071
Gjithsej detyrimet	289,054

Ekuiteti i aksionarëve	
Kapitali aksionar	27,761
Rezervat e kapitalit	324
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	0
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	5,361
Përbërësit tjerë të ekuitetit	0
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	33,466
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	322,501
Pasqyra e të ardhurave me: 31.12.2019	Euro '000
	Tremujori vijues 31/12/2019
Të hyrat nga interesi	15,847
Shpenzimet e interesit	(2,415)
Neto të hyrat nga interesi	13,432
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	3,100
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	(938)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	2,162
Neto të hyrat nga tregtimi	218
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	13
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	(8,559)
Gjithsej të hyrat	7,308
Provizionet për humbjet nga kreditë	(1,318)
Fitimi/(humbja) para tatimit	5,947
Shpenzimet e tatimit në fitim	(587)
Fitimi/(humbja) neto	5,361
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	222
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	5,583

Performanca e Bankës Ekonomike

Duke vazhduar traditën e rritjes dhe ruajtjes së kënaqshmërisë së klientëve, duke punuar vazhdimisht për arritjen e caqeve të performancës financiare, Banka Ekonomike, edhe në vitin 2019, ka shënuar progres në shumicën e treguesve financiarë, duke e mbyllur vitin me fitim para tatimit me 5.95 milionë euro.

Neto të hyrat nga interesi kanë pasur rritje në krahasim me vitin e kaluar për 10 përqind, neto të hyrat nga komisionet kanë shënuar rritje prej 11.6 përqind.

Banka Ekonomike mbetet e përkushtuar që të realizojë planet e saj afatgjata strategjike, në mënyrë që të vazhdojë të kryejë operacionet me sukses gjithmonë në ngritje.

Asetet e bankës

Përkushtimi ndaj vlerave, caqeve të performancës dhe angazhimi i vazhdueshëm drejt zgjerimit të rrjetit dhe infrastrukturës së bankës ka rezultuar në rritje të aseteve të bankës për të pestin vit me radhë. Këtë vit, rol të rëndësishëm në rezultatin e rritjes së aseteve ka pasur edhe rritja e portfolios kreditore. Banka Ekonomike ka mbyllur vitin 2019 me 323 milionë euro për dallim nga 2018, kur kishte 281 milionë euro asete.

Asetet e Bankës Ekonomike




Figura 3: Asetet e Bankës Ekonomike, 2015 - 2019;
Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

Ecuria e kredive

Menaxhimi i duhur i portfolios dhe menaxhimi i balancuar i rrezikut kanë ndikuar që edhe këtë vit të vazhdojë trendi i rritjes dhe Banka Ekonomike të ketë rritje të dukshme në portfolion e kredive, përfshirë sektorin privat dhe atë të biznesit. Gjatë vitit 2019 portfolio e kredive është rritur nga 178 milionë euro në 216 milionë euro. Vlen të theksohet se norma mesatare e ponderuar e tregut ka shënuar rënie nga 6.3 përqind sa ishte në vitin 2018, në 6.1 përqind

në vitin 2019. Të njëjtin trend rënës e përcolli edhe Banka Ekonomike ku shënoi rënie nga 7.2 përqind sa ishte në vitin 2018, në 6.5 përqind në vitin 2019.

Banka Ekonomike ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme produktet e saj më të mira të kredidhënies me fushata marketingu.

Kreditë - Banka Ekonomike




Figura 4: Portfolio e kredive, 2015 - 2019;
Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

Ecuria e depozitave

Rritja e përvitshme e depozitave është një tregues më shumë në shtimin e vazhdueshëm të besimit të klientëve në shërbimet e Bankës Ekonomike. Viti 2019 ka shënuar rritje të depozitave në 285 milionë euro nga 250 milionë euro sa ishte në vitin paraprak.




Figura 5: Depozitat e klientëve, 2015 - 2019;
Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

Të hyrat nga interesi dhe jointerеси

Euro '000	2015	2016	2017	2018	2019
Të hyrat nga interesi	13,571	13,450	13,835	14,503	15,847
Kostot e depozitave	2,896	2,273	2,192	2,296	2,415
Të hyrat NETO nga interesi	10,675	11,177	11,643	12,208	13,432
Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifat	1,496	1,673	1,876	1,420	1,374

Të gjithë shifrat janë në '000 Euro!

Të hyrat nga interesi




Figura 6: Të hyrat neto nga interesi, 2015 - 2019;
Të gjithë shifrat janë në '000 Euro .

Shpenzimet operative

Euro '000	2015	2016	2017	2018	2019
Shpenzimet administrative	3,718	4,081	4,730	4,406	3,767
Shpenzimet e personelit	2,787	2,793	3,109	3,198	3,274
Shpenzimet e zhvlerësimit	845	859	834	863	1,827
Gjithsej shpenzimet operative	7,350	7,733	8,673	8,467	8,868

Të gjithë shifrat janë në '000 Euro!

Shpenzimet operative




Figura 7: Shpenzimet operative, 2015 - 2019;
Të gjithë shifrat janë në '000 Euro .

Gjatë vitit 2019, Banka Ekonomike u ka kushtuar rëndësi të veçantë investimeve në degë dhe infrastrukturë, por në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin dhe trajnimin e personelit që ka rezultuar në rritje të shpenzimeve operative të përgjithshme të bankës dhe rritje të shpenzimeve të zhvlerësimit të aseteve, në krahasim me vitin paraprak, poashtu rritja e shpenzimeve të zhvlerësimit të aseteve gjatë vitit vjen edhe si rrjedhojë e implemtimit të standartit të IFRS 16.

Megjithatë, rishikimi i shpenzimeve operative edhe këtë vit ka qenë një prioritet dhe ka përfshirë rishikimin e të gjitha kategorive të shpenzimeve dhe planifikimin e menaxhimit të tillë në mënyrë që banka të zhvillojë aktivitetin e saj në nivelin më të lartë profesional, por në të njëjtën kohë të sigurojë që shpenzimet dhe kostot të rriten me një ritëm më të ngadaltë se të ardhurat.

Zhvillimi i biznesit

Gjatë vitit 2019, Banka Ekonomike i ka kushtuar një kujdes të shtuar konsolidimit të mirëfilltë të departamenteve të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e biznesit. Në këtë drejtim fokusi ka qenë në aspektin organizativ me ç'rast janë definuar qartë departamente të reja dhe segmente brenda linjave me të cilat do të krijohet shërbim më i mirë ndaj nevojave të konsumatorëve. Si pasojë biznesi është ndarë në departament të korporatës dhe në atë për ndërrmarje të mikro dhe NVM duke marrë si bazë të ndarjes ekspozimin prej 250,000 Euro për klient. Në kuadër të departamentit për individë, është themeluar njësi për klienta VIP e cila synon të ofrojë shërbim më të sofistikuar për një kategori të caktuar të klientëve në bazë të asetëve dhe të hyrave. Në këtë drejtim, krahas departamentit për individë, departamentit të bizneseve të vogla dhe të mesme, është implementuar edhe centralizimi dhe konsolidimi i departamentit të korporatave dhe departamentit të lizingut, me ç'rast janë krijuar kushte më të favorshme për të shërbyer klientët tanë, duke i'u përgjigjur kështu kërkesave të tyre me produkte dhe shërbime të dizajnuara sipas nevojave të klientëve tanë.

Gjatë vitit 2019, në kuadër të segmentit për individë, jemi angazhuar të përmbushim me efikasitet dhe cilësi kërkesat e klientëve të përshtatura në linjë të plotë me nevojat e tyre. Viti 2019 është karakterizuar me një sërë iniciativash drejt implementimit të suksesshëm të produkteve dhe shërbimeve cilësore në linjë me strategjinë e bankës dhe zhvillimet e tregut.

Përgjatë vitit 2019 është bërë ndarja e segmenteve të biznesit, duke mos u ofruar klientëve të korporatave tashmë vetëm shërbime klasike financiare, por një gamë të gjerë shërbimesh, sipas kërkesave dhe specifikave që iu nevojiten.

Duke parë rëndësinë e këtij segmenti të klientëve, banka do të vazhdojë të zhvillojë dhe përshtatë produktet dhe shërbimet e saj në përkrahje të këtyre bizneseve.

Ndërsa, në aspektin e bizneseve të vogla dhe të mesme, në linjë me zhvillimet e tregut dhe synimet për rritje të pjesëmarrjes në tregun e këtyre bizneseve, Banka Ekonomike, gjatë vitit 2019, aplikoi disa ndryshime në qasje duke shtuar fokusin nëpërmjet segmentimit të ri dhe orientimit të degëve nga ky treg. Kjo u përcoll me përshtatjet e nevojshme në mënyrën e organizimit të punës, përmbajtjen e fushatave dhe trajnimin e stafit në gjenerimin dhe menaxhimin e kërkesave të këtij target grupi. Kjo qasje në fund të vitit rezultoi shumë e suksesshme duke shënuar rritje në të gjitha kategoritë kryesore të performancës të kryesuar nga rritja në kredi prej 8.5 milionë Euro ose 19.58 përqind. Një tjetër sferë e suksesshme në të cilën jemi zhvilluar është lizingu, nëpërmjet të cilit synojmë të financojmë nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë. Gjatë vitit 2019, në bazë të kampanjave të targetuara si dhe ekspertizës në njohjen e tregut, banka arriti që të financojë 219 produkte (vetura) në vlerë të lejuar prej 4.24 milionë Euro.

Në kuadër të zhvillimit të produkteve si dhe mitigimit të riskut të normave të interesit, është lansuar produkti me normë variable të interesit për produktet kreditore afatgjata. Ky produkt synon që të mbrojë bankën dhe klientat nga lëvizjet e papritura të normave të interesit.

Banka Ekonomike, gjatë 2019, ka lansuar në kanale të ndryshme të komunikimit disa fushata për kredi individuale, kredi për mikro biznese, agro kredi, lizing dhe gjithashtu edhe për produkte e shërbime të tjera të bankës.

Funksionimi i vazhdueshëm i Bankës Ekonomike ka rezultuar në informimin e publikut për bankën dhe shërbimet bankare e gjithashtu edhe ka rezultuar suksesshëm në shitje, arritje të objektivave të bankës dhe krijim të imazhit pozitiv.

Gjithsej kreditë

Duke u bazuar në realizimin e disa iniciativave strategjike të cilat synonin avancimin dhe rritjen e efijencës në procese, Banka Ekonomike, gjatë vitit 2019, pati vitin më të mirë në historinë e saj në aspektin e biznesit. Suksesin e arritur e fuqizon fakti që rritja ishte e përhapur në të gjitha segmentet: segmenti i bizneseve të vogla dhe të mesme, segmenti i individëve, lizingu dhe korporata. Nëpërmjet kësaj, banka ka arritur që të ketë një rritje dhe diversifikim të riskut konform strategjisë dhe objektivave të biznesit. Në këtë mënyrë ekspozimi kreditor arriti nga 178 milionë euro në 216 milionë euro duke tejkaluar objektivat e përcaktuara në fillim të vitit. Kjo bazë e portfolios si dhe cilësia e saj, japin sinjale që banka ka modelin e duhur të biznesit dhe në të ardhmen duhet të rrisë resurset e saja në këtë drejtim.

Segmenti	Vlera e mbetur 2018 në '000	%	Vlera e mbetur 2019 në '000	%
Individë	68,951	38.70%	79,949	37.06%
NVM	43,850	24.61%	52,440	24.31%
Korporatë	65,050	36.51%	79,170	36.70%
Lizing	307	0.17%	4,155	1.93%
Totali	178,158	100%	215,714	100%

Klientët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Duke u bazuar në rëndësinë e segmentit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për ekonominë e Kosovës, në kuptimin e gjenerimit të punësimit dhe krijimit të vlerave të reja, Banka Ekonomike, gjatë vitit 2019, për shërbime sa më të mira të këtij target grupi u angazhua në një proces të ri-segmentimit të biznesit. Në këtë mënyrë, si kriter segmentimi u definua ekspozimi kreditor me ç'rast klientët me limite deri në 250,000 euro u përcaktuan si klientë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në këtë kuadër dhe nëpërmjet këtij veprimi, banka synon që të ketë një fokus më të madh të resurseve në këtë segment dhe nëpërmjet kësaj të rritet baza e klientëve në numër dhe në volume. Me gjithë këtë ridefinim, ky segment mbetet shumë i gjerë dhe shumëllojshmëri në numër dhe në veçanti të bizneseve me ç'rast paraqiten grupe të ndryshme si: mikrobizneset, bizneset e ndërlidhura me bujqësinë, bizneset e vogla dhe të mesme, bizneset e udhëhequra nga të rinjtë dhe gratë etj.

Kjo iniciativë e fokusuar rezultoi të jetë shumë e suksesshme pasi që efektet ishin pozitive në disa fusha. Në këtë mënyrë, segmenti shënoi një rritje prej 8.5 milionë euro ose 19.58 përqind duke arritur kështu në 52.4 milionë euro. Në këtë drejtim, rritje patën edhe lejimet vjetore me ç'rast pati 42.7 milionë euro lejime në total ose 31.7 përqind më shumë se vitin e kaluar. Kjo rritje ka qenë veçanërisht e theksuar te rastet mbi 50,000 euro ku lejimet arritën në 17.2 milionë euro ose një rritje prej 52.21 përqind krahasuar me vitin paraprak.

Në arritjen e këtyre sukseseve rol të veçantë ka luajtur edhe Fondi për garanci kreditore të Kosovës me ç'rast nëpërmjet këtij mekanizmi janë lejuar 3.7 milionë euro kredi ose një rritje prej 208 përqind në krahasim me vitin paraprak. Duke parë përparësinë që ky fond ofron në tejkalimin e barrierave të kolateralit, Banka Ekonomike synon që të vazhdojë me këtë ritëm të shfrytëzimit.

Krahas aktivitetit në kredidhënie, segmenti ka qenë i fokusuar edhe në shitje të tërthortë duke ofruar një qasje të integruar ndaj nevojave të klientëve për produkte dhe shërbime. Në këtë mënyrë nëpërmjet fushatave të ndryshme, pakove të shërbimeve dhe incentivave të ndryshme për staf banka ka arritur që një pjesë të madhe të klientëve t'i pajisë me E-Banking dhe kartela duke demonstruar edhe një herë orientimin e saj në digjitalizim dhe efijencë në operim. Në këtë drejtim numri i kredit kartelave u rritë për 14.75 përqind duke arritur në 1.991 klienta me kredit kartelë.

Klientët korporatë

Banka edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar të jetë një partner i besueshëm për klientët e të gjitha segmenteve, mirëpo duke parë kërkesat gjithnjë e në rritje të klientëve të korporatave dhe kërkesat e tyre për produkte e shërbime më cilësore dhe profesionale, ka riorganizuar ndarjet e bizneseve për t'iu përgjigjur kështu nevojave të këtij segmenti me zgjidhje të thjeshta dhe fleksibile.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2019 është bërë themelimi, centralizimi dhe konsolidimi i plotë i departamentit për klientë të korporatave, që dëshmon se banka vazhdon të jetë një partner i ngushtë për të gjitha segmentet e ndërmarrjeve, me fokus të veçantë në rritjen dhe mbështetjen e klientëve të korporatave.

Në vitin 2019, pas konsolidimit të plotë të departamentit të korporatës, biznesi i këtij segmenti ka regjistruar një rritje të madhe në portfolion kreditorë, duke rritur kreditë neto me 14 milionë euro ose 21.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2019 kishte edhe përmirësim të cilësisë së aseteve që rezultojnë në kredi jo-performuese, e që përbëjnë vetëm 1.92 përqind të portfolios së kredive, me rënie prej 11.9 përqind (apo 0.26 pikë të përqindjes) krahasuar me vitin paraprak, gjë e cila është arritur me monitorim të afërt të portfolios kreditorë, e posaçërisht duke ruajtur cilësinë e kredive.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është se vëmendje shtesë i është kushtuar sigurimit të përputhshmërisë së plotë me kërkesat rregullatore.

Klientët individualë

Banka Ekonomike, në kuadër të fuqizimit të rolit të klientëve, mbetet bankë e cila mbështet të gjitha kategoritë e klientëve individualë. Ofertat atraktive, mundësitë e personalizuara si dhe procesimi i shpejtë i kërkesave të klientëve në linjë me nevojat e tyre mbeten disa nga karakteristikat kryesore të cilat kanë ndikuar në rritjen e portfolios dhe zgjerimin e bazës së klientëve individualë.

Si pjesë e strategjisë së bankës në kuadër të zhvillimeve operationale, u vijua me optimizimin e proceseve me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të ofrimit të shërbimeve ndaj klientëve. Në linjën e segmentit për individë, përgjatë vitit 2019 u themelua modeli i shërbimit për klientë VIP. Koncepti i klientëve VIP është modeli më i ri i ofrimit të shërbimeve të cilat Banka Ekonomike i ofron për grupin e klientëve, në kuadër të të cilit bëjnë pjesë klientët me të hyra apo edhe kursime më të larta, klientë të cilëve i'u ofrohet trajtim i veçantë në hapësira të veçanta të modeleve të fundit të bankingut modern.

Një nga objektivat tjera strategjike ka qenë fuqizimi i shërbimit cilësor ndaj klientëve ku stafi i shitjes, i pozicionuar në të gjitha degët në Kosovë, është trajnuar dhe orientuar vazhdimisht në ofrimin e shërbimeve cilësore të cilat kanë gjeneruar vlerë të shtuar për klientët dhe si rezultat kanë pozicionuar Bankën Ekonomike në nivelin superlativ të ofrimit të shërbimeve ndaj klientëve.

Në kuadër të rritjes së nivelit të depozitave të personave individualë, Banka Ekonomike ka promovuar paketa të ndryshme të produkteve të depozitave me terma të përshtatura për nevoja të klientëve me skema atraktive të përfitimit të interesave në periudha të ndryshme kohore.

Të gjitha aktivitetet e vitit 2019 në kuadër të individëve, kanë kontribuar që të ketë rritje të konsiderueshme në pikë të përqindjes të portfolios kreditore, më e larta ndër vite deri më tani, prej 15.90 përqind, përqindje kjo prej 5.40 përqind më e lartë se niveli i regjistruar, respektivisht 10.50 përqind.



Klientët e lizingut

Në kuadër të plotësimit të nevojave të klientëve dhe rritjes së aftësisë konkurruese të bankës në treg, gjatë vitit të kaluar banka themeloi njësinë e lizingut dhe rriti gamën e saj të ofertës në treg. Në këtë drejtim, u sigurua që të implementohen proceset e nevojshme si dhe mënyra e re e kreditimit e cila krahas të dhënave financiare bazohet në kreditim në bazë të asetëve. Me këtë qasje banka synoi që ti japë një tjetër shtysë aktiviteteve ekonomike duke rritur mundësitë e financimit.

Të gjitha këto përpjekje përgjatë vitit u dëshmuar si të duhura dhe të suksesshme. Nëpërmjet lizingut banka arriti që të gjenerojë klienta të rinj, limite të reja dhe në rritje të ekspozimit kreditor. Në këtë mënyrë, në total u financuan 47 klientë me 220 produkte kreditore në vlerë të lejuar prej 4.2 milionë euro. Për bankën kjo paraqet një fillim shumë premtues dhe duke u siguruar që ka përkrahjen dhe resurset e duhura, presim që edhe në vitet në vijim të ketë një trend të lartë të rritjes. Gjithashtu, jemi të sigurtë që si njësi e në të ardhmen si departament, lizingu plotëson departamentet tjera të shitjes dhe kontribuon në sinergjinë e duhur që të rrisim prezencën tonë në treg.

Përgjegjësia shoqërore korporative

Angazhimi i Bankës Ekonomike ndaj përgjegjesisë shoqërore korporative është një pjesë strategjike për të bërë biznes. Përgjegjësia sociale korporative është e ngulitur në vlerat tona dhe ndikon se si ne zhvillojmë biznes, zhvillojmë produkte dhe shërbime dhe realizojmë qëllimet dhe angazhimet tona.

Zotimi për të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet me karakter social, kulturor dhe arsimor në ndihmë të komunitetit, ka qenë fryma që ka përshkuar përgjegjësinë sociale të korporatës edhe gjatë vitit 2019.

Përgjegjësia e Bankës Ekonomike ndaj komuniteteve në nevojë e bën bankën të kontribuojë përmes donacioneve në disa institucione të ndryshme. Disa nga iniciativat që mund të përmenden ishin donacionet duke investuar në aktivitete sociale, kulturore, sportive dhe promovuese të artit në të gjithë vendin.

Mbështetja për sportin

Sporti është burim i rekreacionit, që ofron argëtim, aktivitet fizik dhe inkurajon forcimin e shpirtit ekipor. Gjithashtu, mund të krijojë një ndjenjë të unitetit dhe një pjesë të të qenit diçka më shumë se vetja. Andaj, duke i pasur këto parasysh, Banka Ekonomike vazhdimisht është vënë në përkrahje të sportit vendor. Kështu, duke parë entuziazmin dhe përgatitjen e lartë fizike e teknike të skitarëve të vegjël, Banka Ekonomike mbështeti Klubin skitar Prishtina, për t'i mundësuar sado pak në stërvitjen e lojtarëve të rinj, si dhe me qëllim të përhapjes sa më të gjerë të këtij sporti të veçantë në vendin tonë. Klubi ka një histori shumë të pasur në sportin e skitarisë dhe ka shërbyer si një shembull i shkëlqyer i punës së përbashkët ekipore. Në këtë mënyrë ka arritur të aftësojë numër të madh të skitarëve të shkëlqyer dhe gjatë vitit 2018/2019 ka arritur të fitojë 84 medalje në gara Kombëtare/rajonale.

Një aktivitet tjetër që banka mbështeti ishte organizimi i Streetball 3x3 Prishtina, të cilët edhe këtë vit janë licencuar nga FIBA. Ky aktivitet është zhvilluar me rastin e ditës së çlirimit të Prishtinës, si një nga 20 aktivitetet kryesore për nder të kësaj dite, ku pati pjesëmarrës nga e gjithë bota me ekipe me renome si ai nga Chicago, Amerikë, si dhe ekipe të tjera të njohura evropiane.

Gjithashtu, Banka Ekonomike ka mbështetur Klubin e hendbollit Prishtina i cili është ndër klubet më të vjetra dhe më të suksesshme në Kosovë. Klubi i hendbollit Prishtina është klubi i vetëm i cili e përfaqëson Prishtinën në superligën e Kosovës në hendboll. Aktivitet kryesor është ngritja dhe masivizimi i sportit të hendbollit në Prishtinë.

Sporti mbetet një ndër fushat më të preferuara të aspektit të përgjegjësisë sociale korporative të Bankës Ekonomike.



Veprimtaria sociale

Banka Ekonomike si banka e vetme me 100% kapital vendor, për të dytin vit radhazi, i është bashkuar nismës së Transfuzionit të gjakut në fushatën sensibilizuese me rastin e 11 vjetorit të pavarësisë së Kosovës.

Me këtë rast, kemi shndërruar zyrat tona në një ambient të përshtatshëm për dhurim të gjakut dhe punonjësit e Bankës Ekonomike janë treguar të gatshëm për të dhuruar gjakun e tyre në ndihmë të të gjithë personave në nevojë, me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”! Në kuadër të përgjegjësisë sociale edhe në të ardhmen do të vazhdojmë me aktivitete të tilla duke synuar nxitjen e të gjithë shoqërisë e specifikisht të rinjve ndaj këtij akti human.

Synim kryesor i Bankës Ekonomike mbetet përmirësimi i mirëqenies së shoqërisë kosovare, andaj ne asnjëherë nuk ndalojmë angazhimin që t'i kontribuojmë kësaj çështjeje.

Në vazhden e përkushtimit të vazhdueshëm për mbështetjen e organizimeve të cilat ngrisin nivelin e vetëdijesimit dhe përgjegjësisë sociale, me theks të veçantë në sektorë të cilët ndikojnë direkt në mirëqenien e shoqërisë së vendit tonë, Banka Ekonomike mbështeti organizimin e “Kongresit të 16-të të Shoqatës oftalmologjike të evropës juglindore dhe Kongresin e 3-të të Shoqatës së oftalmologëve të Kosovës”, i cili u mbajt me 31 Maj deri 02 Qershor 2019 në Swiss Diamond hotel.

Ky kongres pati për qëllim edukimin dhe avancimin e vazhdueshëm profesional përmes shkëmbimit të përvojave me ligjërues të njohur ndërkombëtar të cilët do t'i ndajnë përvojat e tyre në diagnostikimin dhe trajtimin modern të shumë sëmundjeve që ne i hasim çdo ditë në praktikën tonë, gjë që do të rezultojë në ngritjen e kujdesit personal dhe ruajtjen e shëndetit pamor.



Mbështetja për gratë ndërmarrëse

Banka Ekonomike, për të dytin vit radhazi, në kuadër të përgjegjësisë sociale, ka përkrahur ecjen globale të mentorimit me moton ‘balanco për të mirë’ duke i'u bashkuar iniciativës globale të Vital Voices e cila këtë vit organizohet në 62 shtete të botës me qëllim të fuqizimit të gruas. Ky aktivitet zhvillohet çdo vit në mbarë botën për festimin e ditës ndërkombëtare të gruas, ku mijëra gra e burra, vajza e djem nga e gjithë bota mblidhen në komunitetet e tyre për të marrë pjesë në shëtitje.

Për më tepër, duke qenë se një nga prioritetet e Bankës Ekonomike është përgjegjësia sociale ndaj shoqërisë, me rastin e përrimit të nëndegës në Drenas, Banka Ekonomike ka vendosur t'i dhurojë donacion “Qendrës për promovimin e të drejtave të grave në Drenas”. Angazhimi dhe kontributi i vazhdueshëm për përmirësimin e mirëqenies në shoqërinë kosovare, mbetet një ndër synimet kryesore të Bankës Ekonomike.

Kanalet e distribuimit

Rrjeti i degëve

Teknologjia dhe digjitalizimi i operacioneve biznesore janë kërkesë e kohës, që të gjithë po mundohen t'a zbatojnë, mirëpo as afërsia me klientin nuk duhet lënë anash, sepse teknologjia asnjëherë nuk do të mund ta zëvendësojë kontaktin human.

Andaj, me synimin për të qenë gjithmonë më afër klientëve, Banka Ekonomike ka gjithsej 31 degë, të cilat janë të ndara në 7 degë kryesore dhe në 24 nëndegë. Sipas statistikave nga raporti i përgjithshëm i bankave, Banka Ekonomike renditet e 3-ta sipas prezencës në tregun bankar të Kosovës. Kjo dëshmon edhe një herë se qëllimi i Bankës Ekonomike është të jetë prezente në çdo kënd të vendit. Për të qenë në hap me zhvillimet e fundit

në ofrimin e shërbimeve më cilësore në tregun bankar në vend, Banka Ekonomike i ka kushtuar rëndësi të veçantë rrjetit të degëve të bankës. Gjatë vitit 2019, janë rinovuar degët në pajtueshmëri me standardin e ri me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të shpejta dhe të lehta për klientët. Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit të degëve dhe hapësirave vetëshërbyese, kemi ridizajnuar degën në Prishtinë, nëndegën në Kaçanik, kemi rialokuar degën në Ferizaj dhe qendrën e biznesit në Prishtinë e cila tashmë ofron një nga ambientet më moderne në industrinë bankare për shërbim të klientëve: individë, VIP, mikro, agro, lizing dhe korporatë. Gjithashtu, kemi hapur nëndegën e re në Obiliq.




Figura 8. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar.




Figura 9. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar në përqindje.

Kanalet alternative të distribuimit

Qendra e thirrjeve, si një kanal alternativ dhe i rëndësishëm i shërbimit të klientëve, edhe gjatë vitit të kaluar, ka luajtur rol të rëndësishëm në rritjen e ofrimit të shërbimeve. Përmes qendrës së thirrjeve, Banka Ekonomike ka pranuar kërkesa nga klientët dhe ka ofruar sqarime dhe udhëzime këshilluese rreth produkteve dhe ofertave të bankës.

Në fokus gjatë vitit 2019 ishin sigurimi i shërbimeve profesionale, përkrahja e veprimtarisë afariste dhe rritja e besueshmërisë së klientëve, duke zhvilluar marrëdhënie afatgjata me klientët. Krahas qendrës së thirrjeve, Banka Ekonomike u ka ofruar klientëve përkrahje dhe përkujdes edhe përmes rrjeteve sociale, kanal tash shumë i rëndësishëm dhe praktik.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit për klientët tanë dhe mbulimit sa më të mirë të gjithë territorit të vendit tonë, për të qenë sa më afër klientëve tanë, kemi investuar në rrjetin e ATM-ve, ku përmes 50 ATM-ve në gjithë vendin ofrojmë një infrastrukturë të kënaqshme të shërbimit, në çdo kohë. Gjatë vitit 2019, kemi bërë zëvendësimin e rreth 80 përqind të ATM-ve me versionin e ri të ATM-ve të cilët kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së transaksioneve dhe shërbimeve dhe ngritjen e aspektit të sigurisë. Certifikimi i ATM-ve ka qenë ndër më të avancuarit në Kosovë sipas standardeve më të larta duke ofruar siguri maksimale gjatë operimit. Sa i përket pjesëmarrjes në tregun bankar, për nga numri i ATM-ve kemi marrë pjesë me 10 përqind të tregut. Duke u nisur nga zhvillimi i teknologjisë dhe nga jeta dinamike e fokusi në ofrimin e shërbimeve në çdo kohë, përmes bankomatëve për Bankën Ekonomike ka qenë një ndër prioritetet kryesore. Kjo dëshmohet nga niveli i disponueshmërisë (up time) në shërbim të klientëve, i cili gjatë vitit 2019 ka qenë 97 përqind, ndërsa numri total i transaksioneve në ATM (deponime dhe tërheqje) ka qenë 845.059 apo 13.90 përqind më shumë në raport me vitin paraprak.

Në vitin 2019, deponimi i mjeteve në bankomate është më i lartë në krahasim me vitin paraprak. Viti 2019 ka rritje për 33.77 përqind në numër të deponimeve, ndërsa 25.05 përqind rritje në vlerë në krahasim me vitin paraprak.

VLERA DHE NUMRI I TRANSAKSIONEVE TË DEPOZITUARA NË ATM




Figura 10. Vlera dhe numri i transaksioneve të depozituara në ATM

Gjatë vitit 2019, në përgjithësi, të gjitha llojet e transaksioneve me kartela (deponim, tërheqje dhe blerje) në bankomate dhe POS terminale ka pasur rritje si në numër ashtu edhe në vlerë.

Në vitin 2019, numri i tërheqjeve është rritur për 13.54 përqind, ndërsa vlera për 22.21 përqind në krahasim me vitin paraprak.

VLERA DHE NUMRI I TËRHEQJEVE NË ATM




Figura 11. Vlera dhe numri i tërheqjeve në ATM

Në një hap me zhvillimin e tregut bankar drejt digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve, Banka Ekonomike, gjatë vitit 2019, ka vazhduar me zgjerimin e rrjetit të hapësirave vetëshërbyese, me qëllim të qasjes sa më të lehtë në kryerjen e shërbimeve për klientët, në çdo kohë përgjatë 24 orëve.

Për t'u kompletuar ofrimi i shërbimeve cilësore te klientët, Banka Ekonomike ka një ekip të përkushtuar në çdo degë që siguron që çdo shërbim të ofrohet në mënyrë të duhur dhe çdo kërkesë e klientëve të adresohet me kujdes.

Kujdesi ndaj klientëve

Klientët janë pjesa më e rëndësishme e Bankës Ekonomike, prandaj kujdesi ndaj tyre është një obligim i padiskutueshëm. Përkujdesja ndaj klientëve është e vazhdueshme dhe në rritje. Mendimet dhe sugjerimet e klientëve luajnë rol shumë të rëndësishëm që banka të njohë pritshmërinë e klientëve dhe të zhvillojë produktet që u përshtaten atyre. Banka Ekonomike ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë çdo klienti, duke synuar që përvoja e tyre në bankë të jetë unike, profesionale dhe e kënaqshme.

Njësia për trajtimin e ankesave është përkujdesur që të shërbejë si një qendër e rëndësishme e përkrahjes, ku çdo kërkesë apo sugjerim është trajtuar me përkushtim të madh, si udhërrëfyes për përmirësimin e shërbimeve të ofruara.

Ne do të vazhdojmë edhe më tutje shtimin e kujdesit ndaj klientëve tanë, dhe këtë tashmë po e zhvillojmë secilin vit më shumë.

Menaxhimi i rrezikut

Në kuadër të këtij funksioni përfshihet menaxhimi i rrezikut kreditor, operacional, të tregut, likuiditetit, investimeve apo rreziqeve të tjera. Më qëllim të arritjes se synimeve strategjike hartohen dokumente vjetore - strategji apo politika individuale në mënyrë që të mirëmbahen treguesit kyç të rrezikut. Performanca dhe stabiliteti financiar i bankës është stabil, bazuar në treguesit kryesor të rreziqeve:

- Gjithsej kapitali në raport me mjetet e rrezikuara (14.6 përqind).
- Niveli më i ulët i kredive joperformuese (2.31 përqind).
- Mirëmbajtje e raportit në mes ekspozimeve kreditore me depozita (75.75 përqind).
- Rezervat për humbjet nga kreditë në raport me kreditë joperformuese (143.3 përqind).

Gjatë këtij viti është zbatuar përputhshmëria me infrastrukturën rregullative dhe ligjore duke u përshtatur të gjitha kërkesat që rrjedhin qoftë nga kërkesat e rregullatorit apo standardet e mirënjohura të qeverisjes së institucioneve financiare. Kalkulimi i humbjeve (provizioneve) është avancuar në përputhje me standardet e reja ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) i cili përfshin sistemin e tërësishëm për matje, klasifikim apo njohje të humbjeve të pritura.



Rreziku kreditor

Sikurse çdo institucion tjetër financiar, banka është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor që është ndër rreziqet kryesore me më së shumti ndikim në performancë të përgjithshme në bankë. Për të siguruar vazhdimësi në afarizëm, rreziqet nga ekspozimet kreditore së pari duhet të identifikohen, pastaj të vlerësohet ndikimi i tyre dhe së fundmi duhet të krijohen mekanizma për menaxhimin e tyre, ose së paku për zvogëlimin e ndikimit të tyre deri në një nivel të pranueshëm.

Komponentet me efekt pozitiv në treguesin e kapitalizimit ishin rënia e ekspozimeve të mëdha mbi 10% në raport me kapitalin e klasit të parë, së bashku me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së portfolios kreditore, diversifikimin më të lartë të portfolios së përgjithshme kreditore apo rënien e koncentrimin të portfolios kreditore të ndërmarrjeve dhe ri-shpërndarje me ekonomitë familjare, apo pilotimi i produktit lizing financiar, të cilat e karakterizuan këtë periudhë. Po ashtu, dritare e zvogëlimin të rrezikut kreditor ishte shfrytëzimi i mundësisë së financimit nëpërmjet Fondit Kosovar për garanci kreditore.

Menaxhimi i kredive jo-performuese në fundvit pësoi rënie nga fundviti i kaluar dhe ishte në nivelin më të ulët ndër vite në Bankë Ekonomike. Ky trend ishte ulës dhe ndikoi pozitivisht në rritjen e kapitalit rregullator, përfshirë aktivitetet parandaluese për kredi jo-performuese, si dhe menaxhimin më të mirë për vonesa dhe inkasim për produkte në humbje apo zëra jashtëbilancore. Si masë për zbutjen e rrezikut kreditor në shlyerjen e kredive të financuar nga banka, janë hartuar dokumente në harmoni me standardet dhe politikat e matura bankare, në mënyrë që kolaterali të jetë i përshtatshëm dhe i pranueshëm. Në veçanti është funksionalizuar njësia e kolateralit e cila merret me trajtimin e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit, si dhe monitorimit të tyre.

Një nga komponentët e rëndësishme të qeverisjes për korporata është parimi i kontroleve, të cilat janë kryer me kujdesin e duhur profesional, integritet dhe në mënyrë të pavarur.



Rreziku operacional

Rreziku operacional është i njohur ndryshe si risku i humbjeve të shkaktuara nga proceset e brendshme jo adekuate apo të dështuara, të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme. Banka në aspektin e menaxhimit të rrezikut operacional është përqendruar në atë se si rreziqet e mundshme mund të afektojnë në proceset që zhvillohen në bankë.

Banka vazhdon të mbetet e ekspozuar nga rreziqet e ndryshme operacionale, si rrjedhojë nga avancimet teknologjike në fushën e shërbimeve financiare, ndër të tjera, e kanë bërë këtë rrezik më të ndjeshëm të shkaktuar nga proceset e brendshme jo adekuate apo të dështuara, të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme.

Për të krijuar një kontroll më efektiv mbi rrezikun operacional nevojitet aftësia për të vlerësuar profilin ekzistues të rrezikut të bankës nëpërmjet kategorizimit të këtyre incidenteve në databazën e të dhënave, duke përfshirë ngjarjet që çojnë drejt rrezikut operacional. Për më tepër, banka ka instaluar standarde të rrepta të monitorimit të rrezikut operacional kundrejt raportimeve. Përmes qasjeve të standardizuara në menaxhim të rrezikut operacional kemi arritur përmirësim të dukshëm në cilësinë e të dhënave si pikë kyçe në vendimmarrje në raport me incidentet e paraqitura në komitetet e rrezikut operacional në suaza më të larta menaxhuese.

Gjatë vitit, banka ka qenë e gatshme të artikulojë vullnetin e saj të përgjithshëm ndaj pranimin të rrezikut. Në rastet kur rreziku vlerësohet se është jashtë kornizave të përcaktuara të appetitit, atëherë banka ndërmerr hapa të mëtutjeshëm për zbatim të rrezikut në mënyrë sa më efektive gjatë kontrolleve të implementuara. Një ndër masat më efektive të ndërmarra janë trajnimet që mbahen për staf në të gjitha nivelet në mënyrë që të parashikojnë se çfarë mund të shkojë keq, si dhe automatizimin e proceseve dhe

njohuritë e paraqitura në implementimin e produkteve të reja.

Andaj, me gjithë rritjen e vazhdueshme të ekspozimit ndaj rrezikut operacional, menaxhimi i këtij rreziku ishte adekuat, duke izoluar pasojat e tij si rezultat i aktiviteteve të ndara sipas Baselit. Banka ka arritur të ndërmarrë hapa kundrejt një kontrole sa më efektive mbi menaxhimin e rrezikut operacional, duke implementuar plotësisht vetë vlerësimin e profilin ekzistues të rrezikut të bankës.



Rreziku i likuiditetit dhe tregut

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit dhe afarizmit vazhdon të përfaqësohet nga depozitat të cilat shënuan rritje, kryesisht nga ekonomitë familjare në raport me depozitat e entiteteve juridike. Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet 'mbi 1 vit'. Depozitat me afat maturimit 'deri në 1 vit', dominuan strukturën e depozitave të afatizuara. Për të njëjtin qëllim është ndërtuar modeli i stresimit të depozitave për qëndrueshmëri afatgjatë në bankë. Raportet në mes depozitave dhe ekspozimeve kreditore vazhdojnë të kenë shpërputhje dhe rritje të rrezikut sidomos te pjesa e interesit për ekspozime kreditore afatgjatë, prandaj është zbatuar - produkti i normës variable të interesit me qëllim të menaxhimit të hendekut dhe konkurrencës sa u përket lëvizjeve të normave të interesit.

Investimet kryesore gjatë kësaj periudhe karakterizuan investimet në letra me vlerë dhe bonot e thesarit të Republikës së Kosovës. Kur vlera e një investimi ose një detyrimi rritet (zvogëlohet) për shkak të lëvizjeve në faktorët e tregut, atëherë paraqitet rreziku i tregut. Faktorë mund të jenë ndryshimet në çmimet e tregut, risku i normës së interesit, kurset e këmbimit, ose çmime të tjera që ndikojnë në ndryshimet e tregut.

Rezervat e likuiditetit vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkalluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 42 përqind, në raport me kërkesën ligjore prej 25 përqind. Banka është likuide sepse lehtësisht dhe në kohë përmbush detyrimet aktuale dhe të ardhshme. Gjatë gjithë periudhës janë mirëmbajtur limitet e përcaktuara nga rregullatori, si dhe në baza të rregullta janë monitoruar indikatorët kyç të likuiditetit. Indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për stabilitet të gjithmbarshëm në bankë.

Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit

Është hartuar dokumenti i cili si koncept ka për qëllim të identifikojë, vlerësojë dhe menaxhojë të gjitha rreziqet sipas shtyllës së dytë të standardeve të Baselit për kapital. Ky proces i standardizuar i vlerësimit të brendshëm është i rëndësishëm për planifikimin e shumës, llojit apo kërkesave minimale për kapital, ndaj të cilave banka është e ekspozuar apo mund të ekspozohet në mënyrë që të vazhdojë me operacione të rregullta të biznesit. Rreziqet individuale që rrjedhin prej modelit apo strategjisë gjatë kohëzgjatjes së planit të biznesit, koncentrimi i portfolios kreditorë, kolaterali, operacional, likuiditetit, normës së Interesit etj, përcakton nevojën e planifikimit të kapitalit për këto rreziqe.

Operacionet dhe pagesat

Banka Ekonomike duke qenë e orientuar drejt përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës së shërbimeve ndaj klientëve tanë, në mënyrë që t'i bëjmë më të lehta dhe me të sigurta shërbimet tona, në vitin 2019 kemi zhvilluar dhe implementuar një numër të projekteve zhvillimore që kanë të bëjnë me përmirësimin e proceseve të bankës dhe me plotësimin e kërkesave ligjore. Kemi implementuar platformën e “webservice” të Policisë së Kosovës, përmes të cilit mundësohet realizimi i pagesave online.

Banka Ekonomike po ashtu, gjatë vitit 2019, ka filluar me procesin e personalizimit të kartelave të klientëve brenda Kosovës. Ne gjithashtu kemi rritur aspektin e sigurisë së kartelave duke bërë disa përmirësime në këtë drejtim, veçanërisht në liferimin e kartelave deri te klienti. Një tjetër inovacion që kemi implementuar gjatë vitit 2019 është projekti i kartelave “contactless” ku të gjitha kartelat e reja të lëshuara nga Banka Ekonomike tani e tutje do të jenë me funksion shtesë. Çdo kartelë e re do të jetë e pajisur me teknologjinë e re pa kontakt. Pagesat pa kontakt realizohen përmes teknologjisë së antenës (NFC-Near field communication). Për realizimin e transaksionit nevojitet që edhe POS terminali ku bëhet pagesa të jetë poashtu i aktivizuar me këtë teknologji.

Në vitin 2019, kemi implementuar edhe projektin “3D secure”, i cili është në funksion të rritjes së aspektit të sigurisë për blerjet online, ndërsa tani jemi vetëm duke abonuar klientët.

Transferet kombëtare

Transferet kombëtare në vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak, kanë pasur rritje, si në vlerë, po ashtu edhe në numër të transfereve.

Numri i përgjithshëm i transfereve hyrëse dhe dalëse nga 2.9 milionë sa ishte në vitin 2018 është rritur në 3.2 milionë në vitin 2019, rritje kjo rreth 10 përqind.

Ndërsa vlera e përgjithshme e këtyre transfereve hyrëse dhe dalëse nga 894 milionë në vitin 2018 është rritur në 1.026 miliardë në vitin 2019, rritje kjo për afro 15 përqind në vlerë, e paraqitur edhe në tabelën më poshtë:

Transferet Kombëtare Hyrëse dhe Dalëse

■ Hyrëse ■ Dalëse




Figura 12. Transfere kombëtare, hyrëse dhe dalëse;
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

Transferet ndërkombëtare

Transferet ndërkombëtare në vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak, kanë pasur rritje. Nëse marrim numrin e përgjithshëm të transfereve hyrëse dhe dalëse nga 16 mijë në vitin 2018 është rritur në 18 mijë në vitin 2019, rritje kjo rreth 15 përqind.

Ndërsa vlera e përgjithshme e këtyre transaksioneve për vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur rritje prej 14 përqind, ku në total vlera e transfereve hyrëse dhe dalëse nga 241 milionë në vitin 2018 është rritur në 275 milionë në vitin 2019, të paraqitura në tabelën më poshtë.

Transferet Ndërkombëtare **Hyrëse** dhe **Dalëse**

■ Hyrëse ■ Dalëse




Figura 13. Transfere ndërkombëtare, hyrëse dhe dalëse;
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare

Garancionet dhe Letërkreditë ndërkombëtare në vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak, kanë pasur rritje. Nëse marrim total shumën e garancioneve në këtë vit kemi rritje rreth 90 përqind në valutën euro dhe 100 përqind në valutën dollar.

Garancionet dhe Letërkredi ndërkombëtare



Figura 14. Garancionet dhe Letërkreditë ndërkombëtare ndër vite.
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

Kartelat bankare

Banka Ekonomike, në bashkëpunim me partnerët e saj Master Card dhe Visa, u ofron klientëve kartela debit dhe kredit për kryerjen e shërbimeve brenda dhe jashtë vendit si në bankomatë, POS terminale dhe pagesa online. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i debit kartelave ka arritur në 54 mijë dhe ka shënuar rritje për 11 përqind apo për 5489 debit kartela më shumë se sa viti paraprak, ndërsa numri i kredit kartelave 5 mijë për 2 përqind apo për 118 kredit kartela më shumë.

Kartelat Debit dhe Kredit

■ Debit ■ Kredit




Figura 15. Numri i debit dhe kredit kartelave ndër vite.
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

Teknologjia e informacionit

Gjatë vitit 2019, janë kryer punë të shumta që kanë bërë të mundur ecjen përpara si institucion dhe përmbushjen e strategjisë së teknologjisë në veçanti. Me fillim vit është konsoliduar ekipi dhe janë menaxhuar detyrat fillestare për projektin e ndërrimit të sistemit themelor bankar. Në vazhdim, nga ITD është përpiluar plani i këtij projekti gjigand në përputhje me strategjinë e bankës. Është përmbyllur me sukses projekti i “GAP” analizës për sistemin themelor bankar. Është bërë kalimi i suksesshëm i email dhe aplikacioneve të tjera për kolaborim në Office 365 si zgjidhje ‘cloud’. Është rregulluar kontrata me operatorët telefonikë dhe është riorganizuar sistemi i menaxhimit të SMS-ve me ç’rast është përmirësuar procesi për login në e-banking.

Gjatë vitit 2019, janë përfunduar gjithsej 61 projekte që kanë kontribuar në përmbushje të kërkesave ligjore, përmirësimeve teknike, si dhe kërkesa biznesore. Disa nga to mund t’i veçojmë: SNRF mapimi i suksesshëm, Centralizimi i disbursimeve dhe marrëveshjet automatike, raportimet ndaj autoritetit shtetëror, procesi teknologjik i përmbylljes së vitit i suksesshëm, pilotimi i suksesshëm i projektit për mbikëqyrje të kërkesave të prokurimit, përmirësimi i komunikimit dhe infrastrukturës përmes 'cloud' platformës Office 365, përmbushja e pikave të diktuar nga SWIFT, integrimi me sistemin e policisë për pagesën e gjobave automatikisht, paket e klientëve, etj. Nga departamenti i teknologjisë së informacionit janë përmbyllur mesatarisht 600 kërkesa elektronike çdo muaj në mbështetje operacionale të degëve dhe departamenteve. Gjatë vitit, gjithashtu janë konfiguruar dhe shpërndarë më se 265 asete teknologjike tek departamentet dhe degët. Kemi kryer instalimet dhe konfigurimet e nevojshme për hapjen e degëve të reja: qendër të biznesit, degëve në Ferizaj, Obiliq dhe Kaçanik.

Menaxhimi dhe trajnimi i personelit

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka rol të rëndësishëm në Bankën tonë si një faktor kyç i suksesit në arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave të bankës. Aftësitë profesionale, fryma ekipore, besimi dhe përkushtimi janë virtytet kryesore të punonjësve tanë.

Në fund të vitit 2019, numri i punonjësve ishte 339, nga ta 186 femra dhe 153 meshkuj.

Banka vazhdimisht investon në përmirësimin dhe aftësimin e punonjësve të saj, duke krijuar një mjedis të zhvillimit dhe të mësuarit, kështu për të arritur potencialin e plotë të punonjësve të saj.

Viti 2019 është viti më i suksesshëm për Bankën Ekonomike sa u përket investimit dhe zhvillimit të stafit duke vijuar kështu më një numër të madh të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit. Gjatë vitit 2018, banka ka mbajtur 4.29 ditë trajnimi për staf, ndërsa në vitin 2019 ky numër u rrit në 5.96 ditë trajnimi për staf. Vazhdojnë të mbeten prioritet trajnimet si: trajnimi për parandalimin dhe financimin e terrorizmit, siguria e

informacionit, risku operacional, kujdesi ndaj klientit dhe trajnime të tjera të cilat përgatisin grupe të punëtorëve potencial për pozita menaxheriale (udhëheqës të departamenteve, menaxhera regjional, dhe kordinatorë degësh dhe biznesi) si ato për leadership duke ofruar kështu përvojat dhe praktikat e tyre më moderne trajnuese e profesionale të kësaj fushe si dhe trajnimi mbi aftësitë drejtuese, trajnim për përgatitje të menaxherëve të rinj.

Ashtu sikurse edhe vitet e kaluara, Banka Ekonomike i ka kushtuar vëmendje pjesës së socializimit të punëtorëve ku janë organizuar evente të cilat kanë përfshirë të gjithë punëtorët e bankës, si socializimi në Shqipëri, team building për menxhmentin e bankës.

Poashtu gjatë vitit 2019 është bërë shpërndarja e mirënjohjeve për punëtorët me mbi 10 vjet përvojë pune në Bankën Ekonomike e që numri i tyre arrin në 10 punonjës me këtë rast konfirmohet edhe një herë se Banka Ekonomike vazhdon të jetë punëdhënësi i dëshiruar i cili ofron kushte, kulturë të punës dhe ambient të mirë përbrenda.

Gjatë vitit 2019, Banka Ekonomike vazhdoi organizimin e punës praktike, praktikantët gjatë tre muajve të praktikës patën mundësi të përfitojnë përvojë direkte nga puna në botën reale të biznesit. Studentëve i'u mundësua që të shohin se si dhe ku mund t'i shfrytëzojnë praktikisht njohuritë teorike që kanë mësuar në universitet. Kjo mundësi për studentët është ofruar nga banka me qëllim të mbështetjes së brezit të ri të studentëve për t'i përgatitur ata para një tregu sfidues dhe dinamik.

Pajtueshmëria e përgjithshme

Banka Ekonomike është e përkushtuar dhe e vendosur që aktivitetet e saj t'i zhvilloj në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret, standardet vendore dhe ato ndërkombëtare si dhe praktikat e mira me qëllim të rritjes së bankës në baza të shëndosha. Ky është prioriteti i Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit Ekzekutiv të Bankës Ekonomike.

Për tu siguruar pajtueshmërinë rregullative dhe ligjore, Bordi i Drejtorëve sigurohet për pavarësinë e funksionit të pajtueshmërisë në bankë.

Departamenti i pajtueshmërisë së përgjithshme si funksion i pavarur ka krijuar kornizat e brendshme të monitorimit të pajtueshmërisë dhe për këtë raporton në baza të rregullta tek Bordi i Drejtorëve dhe i njofton Menaxhmentin Ekzekutiv sipas kërkesave të rregullores së qeverisjes korporative të bankave.

Të gjitha dokumentet e brendshme të bankës janë zhvilluar dhe rishikohen në baza të vazhdueshme duke i përcjellur kornizën e re rregullative si vendore dhe atë ndërkombëtare.

Departamenti i pajtueshmërisë në bankë përveç tjerash ka rishikuar kodin e mirësjelljes së Bankës Ekonomike dhe në dakordim me Bordin e Drejtorëve ka përcaktuar kërkesat që punonjësit e bankës pa dallim pozite duhet të ndjekur. Gjithashtu janë krijuar korniza të raportimit të shkeljeve të mundshme të kërkesave të kodit të mirësjelljes dhe kërkesave të tjera si dhe masat eventuale që mund të bëhen.

Ky raportim i mundësohet punonjësve ta bëjnë si në formë anonime apo në formë të identifikueshme ndërsa funksioni i pajtueshmërisë së bashku me Bordin e Drejtorëve i trajtojnë ato tutje. Departamenti i pajtueshmërisë së përgjithshme në baza të vazhdueshme i mbanë të informuar dhe përditësuar me informata Bordin e Drejtorëve, Menaxhmentin Ekzekutiv si dhe departamentet dhe degët për të rehat nga BQK, e tregon impaktin si dhe jep rekomandime për implementimin e tyre.

An aerial photograph showing a winding asphalt road that curves through a dense, green forest on a hillside. The road starts from the bottom left and winds upwards and to the right, disappearing into the trees. The terrain is hilly and covered in various types of trees, including some tall, thin ones and many smaller, bushier ones. The lighting is bright, suggesting a sunny day.

Rrugëtimi vazhdon

Misioni dhe vlerat e Bankës Ekonomike vërehen në secilën degë të saj. Këto vlera do të ruhen gjithmonë në mënyrë që të klientët gjithmonë të ofrohen vetëm produktet më cilësore në tregun bankar. Duke qenë banka e vetme me kapital 100 përqind vendor, Banka Ekonomike do të vazhdojë të japë kontributin dhe të punojë palodhshëm për një shoqëri dhe vend më të mirë. Do të vazhdohet të punohet në zhvillimin e produkteve të diversifikuara bankare, duke ngritur vlerën për klientët, të punësuarit dhe për aksionarët. Me qasjen e saj, Banka Ekonomike synon jo vetëm të ofrojë produkte cilësore bankare të klientët, por edhe të ndërtojë vlera të përbashkëta shoqërore dhe të jetë bankë model i të bërit biznes në Kosovë. Me krenari mund të thuhet që Banka Ekonomike do të vazhdojë rrugëtimin e suksesshëm, duke menduar gjithmonë për Ju.

BANKA EKONOMIKE SH.A.

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me
rregullat e kontabilitetit dhe rregulloret e
Bankës Qendrore të Republikës Kosovës
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(së bashku me raportin e auditorit të pavarur)

Përmbajtja

Faqe

Raporti i auditorit të pavarur

Pasqyra e pozicionit financiar	55
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	56
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	57
Pasqyra e rrjedhës së parasë	58-59
Shënime për Pasqyrat Financiare	60-124

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e Banka Ekonomike sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Ekonomike Sh.a. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Bankës më 31 dhjetor 2019 janë të përgatitura, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK-së").

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEK. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë..

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë më vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë menyrë..

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës..

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Banka mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të ndërpresë së përbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka Ekonomike Sh.a. përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit

Grant Thornton LLC

Prishtinë,
21 Prill 2020



Suzana Stavrikj
Auditor ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Shumat në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	6	24,309	20,759
Balanca me Bankën Qendrore të Kosovës	7	41,844	55,869
Kredi për klientët	8	208,570	170,721
Investime në letra me vlerë	9	35,101	25,496
Prona dhe pajisje dhe Pasuritë me të drejtë përdorimi	10	9,925	6,210
Pasuritë e paprekshme	11	565	568
Pasuri të tjera	12	2,187	1,490
Gjithsej pasuritë		322,501	281,113
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	13	282,683	248,181
Detyrime ndaj bankave	14	2,100	2,091
Borxh i varur	15	1,050	1,050
Detyrimi aktual tatimor		151	76
Detyrime të tjera	16	3,073	354
Gjithsej detyrimet		289,057	251,752
Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	17	27,761	24,543
Rezerva e rivlerësimit	17	324	100
Fitime të mbajtura		5,361	4,718
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		33,446	29,361
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		322,501	281,113

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 60 deri në faqen 124, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Drejtues i Bankës me 21 prill 2020 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:



Z. Fatos Krasniqi
Kryeshef Ekzekutiv



Z. Fitim Rexhepaj
Zyrtar Kryesor për Financa

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Shumat në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënim	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga interesi	18	16,020	14,738
Shpenzimet e interesit	18	(2,371)	(2,296)
Të ardhurat neto nga interesi		13,649	12,442
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	19	2,928	2,642
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	19	(905)	(755)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		2,023	1,887
Të ardhurat e tjera operative	20	177	39
Humbja/fitimi neto nga këmbimi valutor		44	31
Të ardhurat		15,893	14,399
Shpenzimet e personelit	21	(3,275)	(3,199)
Zhvlerësimi pasurive, pajisjeve ROU	10	(1,615)	(719)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	11	(211)	(144)
Shpenzimet tjera	22	(4,310)	(5,058)
Humbjet neto nga zhvlerësimi për kreditë	8	(534)	(29)
Gjithsej shpenzimet operative		(9,945)	(9,149)
Fitimi para tatimit		5,948	5,250
Tatimi në fitim	23	(587)	(532)
Fitimi neto për vitin		5,361	4,718
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
Rivlerësimi i letrave me vlerë (Shënimi 17)		222	(18)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		5,583	4,700

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 60 deri në faqen 124, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

(Shumat në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Totali i kapitalit dhe rezervave
Më 1 janar 2018	21,337	120	4,706	26,163
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët (Shënimi 17)	3,206	-	(3,206)	-
Dividenda e shpërndarë (Shënimi 17)	-	-	(1,500)	(1,500)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital	3,206	-	(4,706)	(1,500)
Fitimi për vitin	-	-	4,718	4,718
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Rivlerësimi i letrave me vlerë (Shënimi 17)	-	(18)	-	(18)
Gjithsej të ardhurat përmbledhëse për vitin	-	(18)	4,718	4,700
Më 31 dhjetor 2018	24,543	102	4,718	29,363
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët (Shënimi 17)	3,218	-	(3,218)	-
Dividenda e shpërndarë (Shënimi 17)	-	-	(1,500)	(1,500)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital	3,218	-	(4,718)	(1,500)
Fitimi për vitin	-	-	5,361	5,361
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Rivlerësimi i letrave me vlerë (Shënimi 17)	-	222	-	222
Gjithsej të ardhurat përmbledhëse për vitin	-	222	5,361	5,583
Më 31 dhjetor 2019	27,761	324	5,361	33,446

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 60 deri në faqen 124, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhës së parasë

(Shumat në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Aktivite operative			
Fitimi para tatimit	23	5,948	5,250
Ndryshime për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	1,826	863
Humbje neto nga dëmtimi i kredive për klientët	8	534	29
Ngarkesa / (lirimi) i provizionit për garancitë	16	16	5
Humbja e asetëve të shlyera	10	-	39
Të ardhurat nga interesi	18	(16,020)	(14,738)
Shpenzimet e interesit	18	2,371	2,296
Humbje para ndryshimeve në pasuri dhe detyrimet operative		(5,325)	(6,256)
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
Rezerva statutore me BQK-në	6	(2,871)	(529)
Kredi për klientët	8	(38,419)	(13,331)
Pasuri të tjera	12	(697)	(787)
Detyrime ndaj klientëve	13	34,510	38,734
Detyrime ndaj bankave	14	9	43
Detyrime të tjera	16	2,718	(114)
		(10,075)	17,760
Interesi i paguar		(2,266)	(1,883)
Interesi i arkëtuar		15,871	14,757
Tatim mbi të ardhurat i paguar		(512)	(612)
Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operative		(3,018)	30,022

Pasqyra e rrjedhës së parasë

(Shumat në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

Aktivite investuese			
Blerja e pronave, pajisjeve dhe pasuritë e paprekshme	10,11	(5,537)	(806)
Blerjet të letrave me vlerë	9	(33,907)	(32,095)
Kthimet të letrave me vlerë	9	24,581	33,037
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) nga aktivitetet investuese		(14,864)	136
Aktivitetet financiare			
Dividentët e paguar		(1,500)	(1,500)
Paratë e gatshme neto (të përdorura) në aktivitetin financiar		(1,500)	(1,500)
Rritja / (ulja) neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj			
Paraja dhe ekuivalentët e saj, fillim të vitit		59,926	31,268
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	6	46,580	59,926

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 60 deri në faqen 124, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a (“Banka”) është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (“BQK”), Banka ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 qershor 2001. Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve të saj në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 04/L-093, të datës 11 maj 2012 “Ligji mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare” (Ligji mbi Banka”). Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime rregullatore dhe pasqyrojnë rregulloret dhe rregullat e kontabilitetit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (“Rregullat e BQK-së”). Rregullat e BQK-së bazohen në vendimet relevante ligjore që definojnë aplikimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (“SNRF”) në Kosovë, por rregullat e BQK-së në veçanti kërkojnë aplikimin e disa trajtimeve të kontabilitetit të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e veçanta të SNRF-së. SNRF 9 nuk është miratuar nga BQK për raportim në vitin aktual, prandaj asnjë kërkesë klasifikimi dhe zhvlerësimi i SNRF 9 e zbatueshme që nga 01 janari 2018 nuk janë miratuar për qëllim të raportimit në Bankën Qendrore.

Rrjedhimisht, këto pasqyra financiare duhet të lexohen si të përgatitura në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe rregulloreve që janë në fuqi në territorin e Kosovës, siç është paraqitur në politikat e rëndësishme kontabël në Shënimin 3 më poshtë.

(b) Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Banka

SNRF 16 efektive për periudhën e raportimit që fillon më 01 Janar 2019.

Në këto pasqyra financiare, Banka ka aplikuar SNRF 16, efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019, për herë të parë. Detajet jepen në Shënimet 3 (m) dhe 10.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Interpretimi 23 Pasiguria për trajtimin e tatimit mbi të ardhurat

Interpretimi adreson kontabilitetin e taksave mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikon në zbatimin e SNK 12 Tatimi mbi të Ardhurat. Ai nuk vlen për taksat ose tatimet jashtë sferës së SNK 12, as nuk përfshin specifikisht kërkesat në lidhje me interesin dhe gjobat që lidhen me trajtime të pasigurta tatimore. Interpretimi adreson posaçërisht sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike konsideron veçmas trajtimet e pasigurta tatimore
- Supozimet që një njësi ekonomike bën për ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbjen e taksës), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë e pashfrytëzuara tatimore dhe nivelet e taksave
- Si njësi ekonomike i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana

Banka përcakton nëse do të marrë në konsideratë çdo trajtim të pasigurt tatimor veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore dhe përdor metodën që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë.

Banka zbaton gjykim të rëndësishëm në identifikimin e pasigurive në lidhje me trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Meqenëse Banka operon në një mjedis kompleks shumëkombësh, ajo vlerësoi nëse Interpretimi kishte një ndikim në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara. Pas miratimit të Interpretimit, Banka ka marrë parasysh nëse ka ndonjë pozicion të pasigurt tatimor, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me çmimet e transferimit. Regjistrimet tatimore të Bankës së Mirë dhe filialeve në juridiksione të ndryshme përfshijnë zbritjet në lidhje me çmimet e transferimit dhe autoritetet tatimore mund të sfidojnë ato trajtime tatimore. Banka përcaktoi, bazuar në studimin e pajtueshmërisë së taksave dhe studimit të çmimeve të transferimit, se ka të ngjarë që trajtimet e saj tatimore (përfshirë ato të filialeve) do të pranohen nga autoritetet tatimore. Interpretimi nuk pati ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Standardet dhe ndryshimet tjera që janë efektive për herë të parë në vitin 2019:

- SNK 28 Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe ndërmarrje të përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015-2017
- Plani, ndryshimi, zvogëlimi ose zgjidhja (Ndryshimet në SNK 19)

Këto ndryshime nuk kanë ndikim në këto pasqyra financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë shpalosje.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(c) Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive që mund të ndikojnë në kornizën e BQK-së për përgatitjen e pasqyrave financiare

Megjithëse këto pasqyra financiare nuk janë përgatitur në përputhje me SNRF, në përputhje me rregulloret e BQK-së, atyre u kërkohet të ndjekin formatin e përgjithshëm të kërkesave të SNRF-ve. Si pasojë, çdo standard i ri i SNRF-ve ose rishikimet, që bëhen efektive, mund të ndikojnë në këto pasqyra financiare.

Një numër i standardeve të reja të SNRF-ve, ndryshimet në standardet e SNRF-ve dhe interpretimet janë efektive për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019. BQK-ja ka lëshuar një udhëzim zyrtar duke konkluduar se SNRF 9 do të miratohet në periudhat e tij të raportimit që fillojnë nga 01 Janari 2020. Banka nuk mund të miratojë këto standarde dhe ndryshime përpara miratimit të BQK-së.

SNRF 9 Instrumente Financiare

SNRF 9 zëvendëson SNK 39 për periudhat vjetore në ose pas 1 janarit 2018 për raportime sipas SNRF-ve dhe ka ndikim të rëndësishëm në industrinë bankare në drejtim të mënyrës se si ata do të klasifikojnë dhe matin aktivet dhe detyrimet financiare dhe më e rëndësishmja në mënyrën se si matet zhvlerësimi me zhvendosjen nga humbjet e bëra deri tek modeli i pritshëm i humbjeve.

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 aktualisht nuk janë të zbatueshme për qëllime të raportimit nën kornizën e BQK-së, pasi që BQK-ja ka rregullat e veta të provizionimit.

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare sipas SNRF 9, përveç instrumenteve të kapitalit dhe derivatet, bazohet në një kombinim të modelit të biznesit për administrimin e pasurive dhe karakteristikave të fluksit monetar kontraktues të instrumenteve. Kategoritë e matjes së SNK 39 të pasurive financiare (vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVPL), të disponueshme për shitje (PVF), mbajtja deri në maturim dhe kostoja e amortizuar) të cilat janë udhëzimet në përgatitjen e pasqyrave financiare sipas rregullave të BQK-së, është zëvendësuar nga:

- Instrumentet e borxhit me koston e amortizuar
- Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), me fitime ose humbje të ricikluara në fitim ose humbje nga çregjistrimi
- Instrumentet e kapitalit neto në FVOCI, pa riciklimin e fitimeve ose humbjeve të fitimit ose humbjes nga çregjistrimi
- Aktivet financiare FVPL

Kontabiliteti për detyrimet financiare mbetet kryesisht i njëjtë siç ishte nën SNK 39.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Standardet dhe interpretimet e reja të mëposhtme janë botuar që nuk janë të detyrueshme për periudhat e raportimit më 31 dhjetor 2019 dhe nuk janë miratuar në fillim nga Banka:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve
- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar
- Reforma e Standardit të Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)

Këto ndryshime nuk kanë ndikim në këto pasqyra financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë shpalosje

(d) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aseteve financiare në dispozicion për shitje, të cilat maten me vlerën e drejtë.

(e) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro e cila është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakuar në mijëshën më të afërt, përveç kur shprehet ndryshe.

(f) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, manaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshim nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementet e rëndësishëm me pasiguri në vlerësime dhe mbi gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet 4 dhe 5.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

(a) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të pasurisë ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të pasurisë ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesa nga pasuri ose detyrime financiare matur me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- Interesa nga investime të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

(b) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një pasuri ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat e tjera nga tarifa dhe komisionet, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve, komisione shitjesh dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritët të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse, njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit. Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(c) Pagesat e qirasë

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

(d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë të tatueshme. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të pasqyronin mënyrën në të cilën Banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendosë vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur ato rimerren, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Mjetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlidhen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendit nga ana e Bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendin respektiv.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura, kreditet tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshme, vetëm në atë masë që është e mundur të gjenerohen fitime të ardhshme të tatueshme përkundrejt të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuria e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(d) Shpenzimet e tatimit (vazhdim)

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

(e) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj rivlerësohen në monedhën funksionale përkatëse të Bankës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në po atë datë.

Fitimi ose humbja nga zërat monetarë përfaqëson diferencën ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit.

Pasuritë dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jomonetarë që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

(f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat dhe huamarrjet dhe borxhet e varura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Banka klasifikon pasuritë e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- kredi dhe llogari të arkëtueshme
- investime të mbajtura deri në maturitet
- mjete financiare në gjendje për shitje

Shiko shënimet 3 (j), (h) dhe (i).

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me kosto të amortizuar. Shih shënimin 3.(k).

(iii) Çregjistrimi

Banka çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjen e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim i veçantë.

Në momentin e çregjistrimit të një pasurie financiare, diferenca midis vlerës kontabël neto të pasurisë (ose vlera kontabël që i përket pjesës së pasurisë së transferuar), dhe totalit të (i) konsideratës së marrë (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar ose detyrim të presupozuar) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje të akumuluar që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Kompensimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ajo synon ose ti shlyejë ato në një bazë neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti tregtar i Bankës.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin pasuria mund të shitet, ose detyrimi të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin. Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - përshembull vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi është i mbështetur plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Nëse një pasuri ose pasiv i matur me vlerën e drejtë ka çmim të ofruar dhe çmim të kërkuar, Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e një depozite të kërkuar nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar.

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve raportohen neto nga zhvlerësimi (ose neto nga provizioni për humbjen e kredive). Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë provizionuar. Pasuritë financiare janë provizionuar kur evidenca objektive demonstroi se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të pasurisë ose grupeve të pasurive.

Për më tepër, provizionet për humbjet nga kreditë përfshijnë humbje të ardhshme të mundshme të vlerësuara nga drejtimi në lidhje me huatë ekzistuese, të cilat mund të bëhen të pambledhshme në varësi të situatës ekonomike, cilësisë së kreditit, riskut të trashëguar në portofolin e huave dhe faktorë të tjerë relevantë.

Evidenca objektive që pasuritë financiare janë provizionuar mund të përfshijë vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ristrukturimin e një kredie apo paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do t'i kishte konsideruar, tregues që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup Pasurish të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit në grup, apo kushtet ekonomike që lidhen me dështimin në bankë.

Provizionet për humbjet nga kreditë përcaktohen sipas rregullores "Menaxhimi i Riskut Kreditor" e cila është aprovuar nga BQK-ja me 26 prill 2013. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë ekspozimet në pesë kategori të rrezikut. Banka i zhvlerëson kreditë dhe paradhëniet përmes zhvlerësimit specifik dhe të përgjithshëm.

Për çdo kategori të rrezikut, normat e mëposhtme minimale të provizionimit janë zbatuar:

Kategoria	Norma minimale e provizionimit
Standarde	1.2%
Dyshimtë	1.2%
Nënstandarde	20%
Dyshimtë	50%
Humbje	100%

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Provizionet për humbjet e mundshme në kredi të klasifikuara si standarde dhe në vëzhgim janë klasifikuar si provizione të përgjithshme. Në përputhje me politikën e brendshme të Bankës për provizionim, norma e cila zbatohet për kategorinë standarde dhe në vëzhgim është 1.2% (2018: 1.2%).

Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni kundrejt huave dhe paradhënies. Kreditë fshihen pasi janë ndërmarrë masat e arsyeshme të mbledhjes në përputhje me politikën e Bankës. Kur një ngjarje pasuese shkakton që shumën e humbjes nga zhvlerësimi të ulët, atëherë ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.

Zhvlerësimi i pasurive financiare të vlefshme për shitje

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidencë objektive që një pasuri financiare ose një grup Pasurish financiare është zhvlerësuar. Në rast të investimeve në kapital të klasifikuara si të vlefshme për shitje, një rënie e ndjeshme ose e shtrirë në vlerën e drejtë të letrave me vlerë nën kosto është konsideruar në përcaktimin nëse pasuritë janë zhvlerësuar ose jo. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston për pasuritë financiare të vlefshme për shitje, atëherë humbja kumulative e matur si diferencë midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi për pasurinë financiare e njohur më parë në fitim ose humbje, është hequr nga të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje në instrumentet e kapitalit nuk kthehen nëpërmjet fitimit ose humbjes. Nëqoftëse, në një periudhë të mëpasshme, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi të klasifikuar si i vlefshëm për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas humbjes nga zhvlerësimi, është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(g) Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartmonedha në arkë (të gatshme), gjendje në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe pasuri financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(h) Investimet e mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas vlerësohen në varësi të klasifikimit të tyre si të mbajtura deri në maturim.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(j) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe paradhëniet bankare për klientët janë klasifikuar si kredi dhe të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(k) Depozitat, borxhet e varura dhe detyrimet tjera

Depozitat dhe borxhet e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim.

Depozitat, borxhet e varura dhe detyrimet tjera maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(l) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga dëmtimet.

Kosto historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Programi kompjuterik i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit e rëndësishëm) të pronës dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve (llogaritur si diferencë midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabel neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese janë kapitalizuar vetëm kur vërtetohet që benefitet ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(I) Prona dhe pajisjet (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pronës dhe pajisjeve zhvlerësohen nga data kur ato janë të vlefshme për përdorim. Amortizimi llogaritet për të shlyer koston e artikujve të pronës dhe pajisjeve minus vlerat e përlllogaritura të mbetura të këtyre asetëve përgjatë jetës së parashikuar të përdorimit. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jeta e dobishme 2019	Jeta e dobishme 2018
Ndërtesa	40 vite	40 vite
Kompjutera dhe pajisje të lidhura me to	5 vite	5 vite
Automjete	5 vite	5 vite
Instalime, mobilje dhe pajisje	5 vite	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qera zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit gjatë afatit më të shkurter të qirasë dhe të jetës së tyre të dobishme. Metodatat e zhvlerësimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në datën e raportimit dhe rregullohen nëse duhet.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(j) Pronat dhe pajisjet dhe me qira

SNRF 16, i zbatueshëm për periudhat e raportimit pas datës 01 Janar 2019 specifikon se si një raportues sipas SNRF do të njohë, matë, prezantojë dhe shpalos qirat. Standardi siguron një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit, duke kërkuar që qiramarrësit të njohin aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiradhëniet, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Banka ka aplikuar SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive dhe për rrjedhojë, informacioni krahasues nuk është rikthyer dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 17 dhe KIRFN 4. Në këtë datë, Banka ka zgjedhur gjithashtu të matë pasuritë me të drejtë përdorimi në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë të rregulluar për çdo pagesë të parapaguar ose të llogaritur të qirasë që ka ekzistuar në datën e tranzicionit.

Detajet e politikave të kontabilitetit sipas SNK 17 dhe KIRFN 4 janë shpalosur veçmas nëse ato janë të ndryshme nga ato nën SNRF 16 dhe ndikimi i ndryshimeve shpaloset në Shënimin 10.

Banka njih një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Pasuria me të drejtë përdorimi fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesa të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të ndodhur dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e aktivin themelor ose për të rivendosur aktivin themelor ose sitin në të cilin është vendosur, më pak çfarëdo stimuluj të marrë me qira të marra.

Pasuria më të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën lineare të drejtpërdrejtë nga data e fillimit deri në fillim të fundit të jetës së dobishme të pasurisë me të drejtë përdorimi ose përfundimit të afatit të qirasë.

Jeta e vlefshme e dobishme të pasurive me të drejtë përdorimi përcaktohet në të njëjtën bazë si ato të pasurive dhe pajisjeve. Për më tepër, pasuritë me të drejtë përdorimi zvogëlohet në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohet për rimarrje të caktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk paguhen në datën e fillimit, duke u zbritur duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, shkalla e huamarrjes shtesë e Bankës.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(j) Pronat dhe pajisjet dhe me qira (vazhdim)

Në përgjithësi, Banka përdor normën e saj të huamarrjes në rritje si normë e skontimit.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë si më poshtë:

- pagesa fikse, përfshirë pagesa fikse në substancë;
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, të matura fillimisht duke përdorur indeksin ose kursin në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i përdorimit nën një mundësi blerjeje që Banka është e sigurt për përdorim të arsyeshëm, pagesat e qirave në një periudhë rinovimi janë opsionale nëse Banka është e sigurtë për një opsion shtesë të përdorimit, dhe gjohet për ndërprerje të parakohshme të një qiraje, përveç nëse Banka është e sigurtë të mos ndërprejë më herët.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit. Rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës për shumën që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, ose nëse Banka ndryshon vlerësimin nëse do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi.

Kur detyrimi i qirasë është ri-matur në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të aktivitetit të së drejtës së përdorimit, ose regjistrohesh në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivitetit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Banka paraqet pasurinë me të drejtë përdorimi, të cilat nuk plotësojnë përkufizimin e pasurisë së investimit në "pronë, fabrikë dhe pajisje" dhe detyrimet e qirasë në "detyrime të tjera" në pasqyrën e pozicionit financiar (shënimi 10).

Me kalimin në SNRF 16 në datën fillestare të aplikimit, përhapja e kredisë së Bankës ishte 2.77%. Norma mesatare e huamarrjes në rritje të aplikuar për njohjen e detyrimit të qirasë në SNRF 16 ishte 3.16%.

Banka përdor një ose më shumë nga përdoruesit praktikë të mëposhtëm sipas SNRF 16.C10, duke e aplikuar atë në bazë të qirasë:

- Përdorimi i një norme të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme;
- Rregullimi i pasurisë së përdorimit të duhur për çdo provizion të njohur të qirasë, në vend të kryerjes së një rishikimi të zhvlerësimit;
- Aplikimi i një përjashtimi nga njohja për qiratë për të cilat afati i qirasë përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe qirave të pasurive me vlerë të ulët (Për këtë qëllim banka ka zgjedhur një prag prej rreth 5,000 €). Banka njeh pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë;
- Duke përjashtuar kostot fillestare direkte nga matja pasurisë me të drejtë përdorimi;
- Përdorimi i mbikëqyrjes, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose ndërprerjen e qirasë.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(j) Pronat dhe pajisjet dhe me qira (vazhdim)

Politika e zbatueshme për kontratat e lidhura nga 1 janari 2019

Në fillimin e një kontrate, Banka vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Banka vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një pasurie të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, dhe duhet të jetë e veçantë fizikisht ose të përfaqësojë në thelb të gjithë aftësinë e një aktivi fizikisht të veçantë. Nëse furnizuesi ka një të drejtë substanciale zëvendësimi, atëherë aktivi nuk identifikohet;
- Banka ka të drejtë të marrë në mënyrë thelbësore të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit gjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Banka ka të drejtë të drejtojë përdorimin e aktivit. Banka ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për të ndryshuar sesi dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi.

Në raste të rralla kur vendimi se si dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi është paracaktuar, Banka ka të drejtë të drejtojë përdorimin e aktivit nëse:

- Banka ka të drejtë të drejtojë aktivin; ose
- Banka projekttoi aktivin në një mënyrë që paracakton se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura ose ndryshuar, në ose pas 1 janarit 2019.

Në fillimin ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Banka i akordon vlerësimet në kontratë secilit komponent të qirasë në bazë të çmimeve të tyre individuale. Sidoqoftë, për qiradhëniet e tokës dhe ndërtesave në të cilat është qiramarrëse, Banka ka zgjedhur të mos ndajë komponentët e qiradhënies dhe të mos japë llogari për komponentët e qirasë dhe të qirasë si një komponent të vetëm të qirasë.

Politika e zbatueshme për kontratat e lidhura para 1 janarit 2019

Për kontratat e lidhura para 1 janarit 2019, Banka mati të Drejtën e Aseteve të Përdorimit të barabartë me Detyrimin e Qiradhënies. Në përcaktimin nëse marrëveshja ishte apo përmbante një qira bazuar në vlerësimin nëse:

- Përmbushja e aranzhimit varej nga përdorimi i një pasurie ose aktiveve specifike; dhe
- marrëveshja kishte përcjellë një të drejtë për të përdorur aktivin. Një aranzhim transferoi të drejtën e përdorimit të aktivit nëse njëra nga sa vijon është përmbushur:

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(j) Pajisjet dhe prona me qira (vazhdim)

- i) blerësi kishte aftësinë ose të drejtën për të operuar me aktivin duke marrë ose kontrolluar më shumë sesa një sasi e parëndësishme e prodhimit;
- ii) blerësi kishte aftësinë ose të drejtën të kontrollonte hyrjen fizike në aktiv, ndërsa mernte ose kontrollonte më shumë sesa një sasi e parëndësishme e prodhimit; ose
- iii) faktet dhe rrethanat treguan se ishte e largët që palët e tjera do të merrnin më shumë sesa një sasi e parëndësishme e prodhimit, dhe çmimi për njësi nuk ishte as i caktuar për njësi të prodhimit, as të barabartë me çmimin aktual të tregut për njësi të prodhimit.

(k) Pasuritë e pa prekshme

Softueri i marrë nga Banka matet me kosto më të ulët të amortizimit të akumuluar dhe humbje të akumuluar të zhvlerësimit. Shpenzimet pasuese për pasuritë e softuerit kapitalizohen vetëm kur ato rritin përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruara në aktivin specifik, me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen siç ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë vlerësimit të jetës së dobishme të aktivit, nga data kur është në dispozicion për përdorim.

Softueri është amortizuar duke përdorur metodën e linjës së drejtpërdrejtë gjatë jetëgjatësisë së përdorimit të vlerësuar prej pesë vjetësh. Metodatat e amortizimit, jetëgjatësia e përdorimit dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

(l) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Bankës, përveç pasurive për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të saj e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e të hollave të ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë aktualizimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbja nga rënia në vlerë anulohet vetëm deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, në qoftë se nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(m) Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohej për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme të pritura të pasurive monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Efekti i aktualizimit njihet si kosto financiare.

(n) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

(o) Garancitë financiare dhe angazhimet për hua

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të paracaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

(p) Dividendët

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen në kapital në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit dhe Bordin e Drejtorëve zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël kryesore të Bankës dhe zbatimin e tyre, si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vleresimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një rrezik të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe gjykimet kryesore në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta, janë shpalosur më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e riskut financiar (shih shënimin 26).

(a) Zhvlerësimi

Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuara vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave të kontabilitetit të përshkruara në 3(f)(vii).

Banka rishikon portfolion e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin së paku në baza tremujore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave apo jo, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të parasë nga portofoli i kredive para se rënia mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol.

Kjo evidence mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, apo në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mungesa në pasuritë e Bankës.

Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike të humbjeve për pasuritë me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolin kur bëhet caktimi i flukseve të ardhshme të parasë.

Banka përcakton se investimet të vlefshme për shitje zhvlerësohen kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim së çfarë është e rëndësishme ose e shtyrë kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson në mesin e faktorëve të tjerë, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm, kur ka prova të përkeqësimit në pozicionin financiar të të investuarit, performancës së industrisë dhe të sektorit, ndryshimet në teknologji dhe flukset operative dhe të financimit të mjeteve monetare.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(b) Përcaktimi i vlerave të drejta

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka asnjë çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në shënimin 3.(f)(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë transparencë të ultë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varesi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut në tregje Pasuri për instrumentet identike.
- Niveli 2: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të vlerësueshme.
- Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke shfrytëzuar: çmimet e kuotuar të tregut për instrumente të ngjajshme në tregje Pasuri; çmimet e kuotuar për instrumente të ngjajshme në tregje të cilat konsiderohen më pak se Pasuri; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në mënyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të rëndësishme të pa vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet për të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngjashme për të cilat rregullime apo gjykime materiale të pavëzhgueshme kërkohen për të reflektuar dallimet në mes të instrumenteve. Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin 5.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Paraqitja dhe përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerave reale bazohen në instrumente financiare ekzistuese në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare.

Instrumentet financiare të matur me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të matura me vlerën e drejtë dhe analizen e tyre sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën secila matje me vlerën e drejtë është kategorizuar. Vlerat janë bazuar në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlera e drejtë e letrave me vlerë të investimeve është e bazuar në çmimet e tregut ose kuotimet broker / dealer të çmimeve. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të skontimit të flukseve monetare të bazuara në një kurbë aktuale të të ardhurave të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Pasuritë financiare të vlefshme për shitje	Vlera	Vlera e drejtë Nivel		
	Kontabël	1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3
31 Dhjetor 2019	30,319	-	30,319	-
31 Dhjetor 2018	20,715	-	20,715	-

Bono thesari në dispozicion për shitje

Bono thesari të vlefshme për shitje përfshijnë bonot e thesarit të lëshuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat nuk janë mbajtur për tregtim e as nuk mbahen në maturim.

Obligacionet e thesarit në dispozicion për shitje

Obligacionet e thesarit të disponueshme për shitje përfshijnë bonot e thesarit të lëshuara nga Qeveria e Kosovës të cilat blihen ose do të shiten ose do të mbahen deri në maturim në varësi të nevojave të likuiditetit të Bankës. Ne si Bankë në portofolin tonë të investimeve financiare kemi Obligacione të Thesarit duke filluar nga maturimi 2 vjeçar deri në 5 vite në monedhë në EUR

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Paraqitja dhe përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Instrumentet financiare jo të matur me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare jo të matura me vlerën e drejtë dhe analizën sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën secila matje me vlerën e drejtë është kategorizuar.

	Vlera Kontabël		Vlera e drejtë	
	2019	2018	Niveli 2 2019	Niveli 2 2018
Pasuritë				
Paraja e gatshme dhe në banka	24,309	20,759	24,309	20,759
Gjendja me BQK	41,844	55,869	41,844	55,869
Kredi për klientët	208,570	170,721	208,570	170,721
Investimet në letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	4,783	4,781	4,783	4,781
Detyrimet				
Detyrimet ndaj klientëve	282,682	248,181	282,682	248,181
Detyrimet ndaj bankve	2,100	2,091	2,100	2,091
Borxhet e varura	1,050	1,050	1,050	1,050

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Paraqitja dhe përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Instrumentet financiare të matur me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë (vazhdim)

Vlerësimet e vlerave reale bazohen në instrumente financiare ekzistuese në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare.

Llogaritë me bankat

Detyrimet me bankat e tjera përfshijnë plasmanet ndërbankare dhe llogaritë. Përderisa balancat me bankat janë afatshkurtër, vlera e tyre e drejtë është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Bonot e thesarit të mbajtura deri në maturim

Bonot e thesarit të mbajtur deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit të lëshuar nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për t'i mbajtur deri në maturim. Për Bonot e thesarit afat të shkurtër, vlera e tyre e drejtë është konsideruar si jo shumë e ndryshme nga vlera kontabël.

Obligacionet e mbajtura deri në maturim

Obligacionet janë obligacionet e emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për tu mbajtur deri në maturim. Çmimet e kuotuar në tregjet Pasuri nuk ishin të vlefshme për këto letra me vlerë. Megjithatë, ka pasur informacione të mjaftueshme të vlefshme për të matur vlerat e drejta të këtyre letrave me vlerë në bazë të inputeve të vëzhgueshme të tregut duke përdorur një model aktualizimi të flukseve bazuar në një normë aktuale të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim.

Kreditë dhe paradhëniet me klientët

Ku është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Ku transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur metodat e vlerësimit, të tilla si teknikat e fluksit monetar të skontuar. Teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredise, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit të kredive tregtare dhe të bizneseve të vogla, kreditë homogjene grupohen në portofole me karakteristika të ngjashme.

Detyrimet ndaj klientëve dhe borxhi i varur

Vlera e drejtë e borxhit të varur dhe detyrimeve ndaj klientëve janë vlerësuar duke përdorur teknika të aktualizimit të rrjedhes së parasë, duke zbatuar normat që janë ofruar për depozitat dhe për borxhin e ndërvarur me maturitete dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkeses është shuma e pagueshme në datën e raportimit. Depozitat kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar të përafërt me vlerën kontabël në varësi të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normave bazë të interesit që janë të përafërta me normat e tregut. Shumica e depozitave janë subjekt i rivlerësimit brenda viti

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Paraja e gatshme dhe në banka

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Paraja e gatshme	10,146	8,592
Llogari rrjedhëse me bankat	14,163	12,166
	24,309	20,759

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Paraja e gatshme dhe në banka	24,309	20,759
Gjendje me BQK (Shënimi 7)	41,844	55,869
Rezerva e detyrueshme	(19,573)	(16,702)
	46,580	59,926

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e detyrueshme për qëllime të likuiditetit, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me maturitet deri në një vit, si rezerva të detyrueshme. Rezervat e detyrueshme kërkojnë instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë para të gatshme, llogaritë në BQK, ose në bankat e tjera në Kosovë, si dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit të rezervave të detyrueshme.

Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në EUR me BQK-në dhe 50% e ekuivalentit në EUR të parave të gatshme të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

7. Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Rezerva e detyrueshme me BQK	19,573	16,702
Llogari rrjedhëse	22,271	39,167
	41,844	55,869

8. Kredi për klientët

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Kredi	180,884	149,846
Mbitërheqje	34,892	28,338
	215,776	178,184
Interesi i përlllogaritur	901	832
Tarifa disbursimi të shtyra	(963)	(857)
	215,714	178,159
Provizione për humbjet e kredive	(7,144)	(7,438)
Kreditë për klientët	208,570	170,721

Kreditë paraqiten në vlerën nominale, interesi i përlllogaritur bazohet në normat nominale të interesit ndërsa tarifat e shtyra të disbursimit janë tarifa shtesë që janë pjesë e normës efektive të interesit.

Maturiteti për kreditë afatgjata varion nga 1 deri në 30 vite (2018: 1 deri 30 vite). Në 2019, norma e interesit për kreditë ndaj klientëve varioi nga 2.70% në 24% n.v. (2018: 2.50% në 24% n.v.). Banka ka dhënë disa hua me normë interesi në limitin minimal të treguar më lartë, të cilat janë norma më të ulëta se ato që ofrohen përgjithësisht nga Banka dhe mbulohen nga kolaterali i parasë së gatshme.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

8. Kredi për klientët (vazhdim)

Lëvizjet në provizionet për humbjet e klientëve janë si mëposhtë:

	2019	2018
Lejimet për provizionet e kredive në 1 janar	7,438	8,248
Kredi të fshira	(1,594)	(2,434)
Rimarrje nga kreditë e fshira më herët	766	1,595
Ngarkesa / (zbritja) për vitin, neto	534	29
Lejimet për provizionet me 31 Dhjetor	7,144	7,438

Kategoria	2019			2018		
	Me kosto të amortizuar	Provizione për humbje	Gjendja neto	Me kosto të amortizuar	Provizione për humbje	Gjendja neto
Standarde	204,039	2,672	201,368	167,080	2,135	164,945
Në vrojtim	5,501	74	5,426	4,325	71	4,254
Nënstandarde	1,190	239	951	863	173	690
Të dyshimta	1,328	503	825	1,674	842	832
Të humbura	3,656	3,656	-	4,217	4,217	-
Totali	215,714	7,144	208,570	178,159	7,438	170,721

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Investime në letra me vlerë

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Të mbajtura deri në maturitet		
Bono thesari qeveritare	-	-
Obligacione qeveritare	4,743	4,743
Interes i llogaritur	40	38
Gjithsej letra me vlerë të mbajtura deri në maturitet	4,783	4,781
Të vlefshme për shitje		
Bono thesari qeveritare	5,201	5,477
Obligacionet qeveritare	25,005	15,180
Interesi i llogaritur	112	58
Gjithsej letra me vlerë të vlefshme për shitje	30,318	20,715
Gjithsej investime në letrat me vlerë	35,101	25,496

Investimet financiare paraqesin Obligacione nga një muaj deri në pesë vite dhe Bono thesari të shprehura në EUR, portofolio e investimeve të Bankës klasifikohet në dy pjesë të Mbajtura deri në Maturitet dhe të Vlefshme për shitje, dhe të gjitha këto investime janë investuar në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës. Interesi mesatar i investimeve të regjistruara në Mbajtje deri në Maturim është 3.20% ndërsa maturiteti është deri në 5 vite.

Bonot e thesarit që kategorizohen si të Vlefshme për shitje është bono një vjeçar dhe interesi është 0.41%. Shuma më e madhe e investimeve tona financiare mbulohet nga Bonot e thesarit të klasifikuara si të Vlefshme për shitje, mesatarja e maturimit për këto bono është rreth 2 vite dhe mesatarja e interesit është 1.23%

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Investime në letra me vlerë (vazhdim)

Tabela në vijim paraqet lëvizjen e investimeve të gatshme për shitje gjatë vitit 2019 dhe 2018:

	AFS investimet
Më 1 janar 2019	20,657
Shtesat	33,908
Heqjet/të maturuara	(24,581)
Fitimi/(humbja) e perealizuar	222
Më 31 dhjetor 2019	30,206
Më 1 janar 2018	24,583
Shtesat	32,095
Heqjet/të maturuara	(36,003)
Fitimi/(humbja) e perealizuar	(18)
Më 31 dhjetor 2018	20,657

10. Prona, pajisje dhe ROU

Më poshtë është një ndarje e pronave dhe pajisjeve në pronësi dhe me qira:

	2019	2018
Prona, dhe pajisjet në pronësi	7,275	6,210
Pasurit e përdorimit të së drejtës (ROU) IFRS 16	2,650	-
Prona, dhe pajisjet në pronësi	9,925	6,210

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

10. Prona, pajisje dhe ROU (vazhdim)

Banka posedon me qira shumë ndërtesa. Informatat në lidhje me qiratë për të cilat Banka është qiramarrëse paraqitet më poshtë.

	2019
	Prona
Balanci më 1 Janar	-
Korrigjimi i bilanceve fillestare	2,714
Shtesat në vitin actual	551
Shpenzimet e zhvleresimit per vitin	(835)
Balanci me 31 Dhjetor	2,650

Tabela e mëposhtme paraqet analizën e maturimit - flukset monetare kontraktuale të padiskontuara të detyrimit të qirasë:

	2019
Më pak se një vit	3,065
Një deri në pesë vite	649
Detyrimet totale me qira të padiskontuara më 31 dhjetor	3,714
Detyrimet e qirasë të përfshira në Notën 16 më 31 dhjetor	2,681

Vlerat e njohura në Pasqyrën e të ardhurave të Bankës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019:

	2019
Interesi mbi detyrimet e qirasë SNRF 16	(77)
Zhvlerësimi për ROU (shënimi 22)	(835)
Shpenzimet totale nga qiratë	(912)

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

10. Prona dhe pajisje

	Ndërtesa	Përmirësime në objekte me qira	Mobiljet, instalime dhe pajisje	Kompjuterat dhe pajisje të lidhura	Automjete	Gjithsej
Kosto						
Në 1 janar 2018	5,634	956	3,542	1,722	601	12,455
Shtesat	-	72	280	162	94	608
Heqjet	-	(242)	(469)	(518)	(123)	(1,352)
Në 31 dhjetor 2018	5,634	786	3,353	1,366	572	11,711
Shtesat	-	447	1,090	167	141	1,845
Heqjet	-	-	(1)	(1)	(38)	(40)
Në 31 dhjetor 2019	5,634	1,233	4,442	1,532	675	13,516
Zhvlerësimi akumuluar						
Në 1 janar 2018	1,128	570	2,870	1,058	469	6,095
Shpenzimi për vitin	141	95	210	220	53	719
Heqjet	-	(267)	(449)	(474)	(123)	(1,313)
Në 31 dhjetor 2018	1,269	398	2,631	804	399	5,501
Shpenzimi për vitin	141	128	235	206	70	780
Heqjet	-	-	(1)	(1)	(38)	(40)
Në 31 dhjetor 2019	1,410	526	2,865	1,009	430	6,241
Vlera Kontabël						
Në 1 janar 2018	4,506	386	672	664	132	6,360
Në 31 dhjetor 2018	4,365	388	722	562	173	6,210
Në 31 dhjetor 2019	4,224	707	1,577	523	245	7,275

Gjatë vitit 2019, Banka nuk ka hequr aktivet nga librat kontabël, (gjatë vitit 2018, Banka ka hequr aktivet me vlerë kontabël neto prej 39 mijë Euro) të cilat njihen në shpenzimet e tjera operative (referojuni Shënimit 21).

Me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 Banka nuk ka ndonjë pronë ose pajisje të vendosur si peng për kolateral.

Vlera kontabël e pasurive të trupëzuara dhe të patrupëzuara të Bankës në 31 dhjetor 2019 ishte 7,840 mijë EUR duke përfaqësuar 25.02% të Kapitalit të Nivelit të Parë. (2018: 6,778 mijë EUR duke përfaqësuar 24.52% të Kapitalit të Nivelit të Parë). Limiti maksimal rregullator është 50% i Kapitalit të Nivelit të Parë. Në vitet 2018 dhe 2019 nuk u raportua tejkalim i kësaj norme.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

11. Pasuritë e patrupëzuara

	Programe kompjuterike
Në 1 janar 2018	1,339
Shtesat gjatë vitit	198
Heqjet	-
Në 31 dhjetor 2018	1,537
Shtesat gjatë vitit	208
Heqjet	-
Në 31 dhjetor 2019	1,745
Amortizimi akumuluar	
Në 1 janar 2018	825
Shpenzimi për vitin	144
Në 31 dhjetor 2018	969
Shpenzimi për vitin	211
Në 31 dhjetor 2019	1,180
Vlera kontabël	
Në 1 janar 2018	514
Në 31 dhjetor 2018	568
Në 31 dhjetor 2019	565

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

12. Pasuri të tjera

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Parapagimet	1,502	746
Të tjera	685	744
Totali	2,187	1,490

13. Detyrime ndaj klientëve

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Depozita me afat	135,727	129,627
Llogari rrjedhëse	117,112	92,844
Llogari kursimi	17,037	14,724
Depozita Flexi	6,133	6,557
Llogari të bllokuara	4,503	2,506
Interes i llogaritur	2,171	1,923
Gjithsej	282,683	248,181

Llogaritë rrjedhëse nuk sjellin interes.

Normat mesatare efektive të interesit për depozitat me afat në vitin 2019 dhe 2018 ishin si vijon:

Viti	1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 -5 vite
2019	0.06%	1.76%	1.41%	1.29%	1.91%	2.30%
2018	0.10%	1.24%	1.36%	1.35%	1.86%	2.31%

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

14. Detyrime ndaj bankave

Detyrimet ndaj bankave prej 2,100 Euro (2018: 2,091 mijë Euro) përfaqësojnë llogari rrjedhëse me bankat vendase.

15. Borxhi i varur

	2019	2018
Borxhi i varur	1,000	1,000
Interesi i llogaritur	50	50
Gjithsej	1,050	1,050

Gjatë vitit 2014, Banka nënshkroi një marrëveshje borxhi të varur me Mabetex Properties Sha. Borxhi i varur prej EUR 1,000 mijë bart një normë vjetore interesi prej 7.5% dhe maturohet në 30 prill 2020.

16. Detyrime të tjera

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Shpenzimet e llogaritura	191	195
Të tjera taksa të pagueshme	75	65
Të pagueshme për pension dhe asistencë sociale	24	23
Detyrimet e qirasë (Shënimi10)	2,681	-
Provizione për çështje gjyqësore	7	-
Të tjera të ardhura të shtyra	65	52
Provizione për humbje nga garancitë	28	19
Gjithsej	3,073	354

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

16. Detyrime të tjera (vazhdim)

Lëvizjet për provizionet për humbje nga garancitë e lëshuara nga Banka janë si vijon:

	2019	2018
Provizionet më 1 janar	19	14
Të lëshuara gjatë vitit (shënimi 20)	9	5
Provizionet në 31 dhjetor	28	19

17. Ekuiteti dhe rezervat

Kapitali aksionar i nënshkruar dhe paguar i Bankës përbëhet nga 108,441 aksione të zakonshme (2018: 95,873) me vlerë nominale 256 Euro secili (2018: 256). Struktura aksionare e Bankës është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019		Më 31 dhjetor 2018	
	%	Shuma	%	Shuma
Behgjet Pacolli	35	9,668	35	8,547
Immobiliare Red Llc	29	7,927	29	7,009
Selim Pacolli	18	5,058	18	4,471
Xhabir Kajtazi	12	3,285	12	2,905
Ismet Gjoshi	3	932	3	824
Hasan Hajdari	1	280	1	248
Zyhra Hajdari	1	269	1	238
Të tjerë me më pak se 1%	1	342	1	301
	100	27,761	100	24,543

Shpërndarja e fitimit dhe dividendës së deklaruar

Mbajtësit e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë kur deklarohen herë pas here dhe kanë të drejtën e një vote për aksion. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Bankës.

Gjatë vitit, bazuar në një vendim për shpërndarjen e fitimit, Banka shpalli një dividend në mjete monetare në vlerë prej 1,500 mijë Euro. Pjesa tjetër i është ndarë kapitalit aksionar si dividend në aksione në shumë prej 3,218 mijë euro me rritje shtesë për 12,568 aksione.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

17. Ekuiteti dhe rezervat (vazhdim)

Në përputhje me ligjin nr.04/L-093 për "Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Financiare Jobankare" minimumi i kapitalit të paguar për bankat vendase që veprojnë në Kosovë është 7 milion euro.

Lëvizja në rezervën e rivlerësimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Rezerva e rivlerësimit më 1 janar	102	120
Rezerva e rivlerësimit të AFS	222	(18)
Balanca më 31 dhjetor	324	102

18. Të ardhurat neto nga interesi

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga interesi		
Kredi dhënë klientëve	15,315	14,210
Depozita dhe gjendje me bankat	45	29
Investime në letra me vlerë	660	499
Totali i të ardhurave nga interesi	16,020	14,738
Shpenzimet e interesit		
Depozita të klientëve	(2,296)	(2,221)
Borxhi i varur	(75)	(75)
Totali i shpenzimeve të interesit	(2,371)	(2,296)
Të ardhurat neto nga interesi	13,649	12,442

Banka nuk njeh të ardhura nga interesi për kredi jo performuese me më shumë se 90 ditë vonesë.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

19. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Shërbimet bankare	2,829	2,600
Garancitë	99	42
Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet	2,928	2,642
Shpenzime për Swift	(903)	(749)
Tarifa për licensë dhe tarifa të tjera rregullatore	(2)	(6)
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(905)	(755)
Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	2,023	1,887

20. Të ardhura të tjera operative

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Të ardhura të tjera	177	39
Gjithsej	177	39

21. Shpenzimet e personelit

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Paga dhe rroga	3,041	2,978
Kontribute për pension	154	153
Kompensime të tjera	80	68
Gjithsej	3,275	3,199

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 347 (2018: 332).

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

22. Shpenzimet e tjera operative

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Sigurimi	1,070	1,112
Qiraja	-	806
Shpenzimet operacionale Mastercard	520	446
Riparimet dhe mirëmbajtja	482	425
Tarifat e sigurimit të depozitave	463	407
Shërbime të TI	371	466
Shërbime komunale dhe karburanti	236	226
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	220	274
Tarifa ligjore dhe profesionale	183	180
Shërbimet për mbledhjen e kredive	108	122
Komunikimi	86	91
Interesi mbi detyrimet e qirasë SNRF 16	77	-
Fshirja e pasurive të tjera	-	39
Materialet për zyrë	28	38
Printime	11	7
Shpenzimi/ Kthimi i provizioneve për humbje nga garancitë	9	5
Udhëtime	6	6
Të tjera	440	408
Totali	4,310	5,058

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

23. Shpenzimet e tatim fitimit

Tatim fitimi në Kosovë llogaritet në shkallën 10 % (2018: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Shpenzimi për tatimi actual	587	532
Gjithsej	587	532

Në vijim paraqitet një barazim i rezultatit kontabël me tatim fitimin:

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Ftitimi para tatimit në fitimit	5,989	5,250
Tatimi në shkallën 10%	599	525
<i>I rregulluar për:</i>		
Shpenzime jo të zbritshme	43	14
Shpezime shtesë interesi, të zbritshme	11	43
Të ardhura jo të tatueshme	(66)	(50)
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	587	532

Për shkak se nuk ka dallime të rëndësishme midis fitimit tatimor dhe fitimit sipas këtyre pasqyrave financiare, Banka nuk ka njohur tatimin e shtyrë, prandaj shënimi i mësipërm përfshin vetëm tatimin actual.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

24. Zotimet dhe detyrime kontigjente

Banka lëshon garanci për klientët e saj. Këto instrumente mbartin një rrezik kreditimi të ngjashëm me ato të kredive të dhëna klientëve. Bazuar në vlerësimet e menaxhmentit, Banka nuk do të ndodhin humbje materiale, në lidhje me garancitë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

Garancitë	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Të siguruara me depozita në mjete monetare	350	2,295
Të siguruara me kolaterale te tjera	1,804	1,462
	2,154	3,757
Angazhimet për kredi		
Kredi të aprovuara por të padisbursuara	4,334	4,426
Overdraftet	9,956	6,983
Kredit kartelet	1,521	1,884
Limite të kartave të kreditit të pashfrytëzuara	15,811	13,293

Kolaterale të tjera për garanci përfshijnë kryesisht pengjet dhe pasuritë e paluajtshme.

Zotimet përfaqësojnë bilancet e huaja të kredive, mbitërheqje dhe kufizimet e kartave që u jepen klientëve.

Zotimet për qiranë operative

Banka ka hyrë në zotime të paanulueshme qiraje si më poshtë:

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Brenda një viti	638	641
	638	641

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

24. Zotime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

Marrëveshjet e rëndësishme të qirave për Bankën përfshijnë marrëveshjet për qira në degët kryesore të vendosura në qytetet e Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Prizrenit, Mitrovicës, Gjilanit, Ferizajt dhe Zyrës Qendrore, duke përfshirë në këto vende. Të pagueshmet e kushtëzuara për qira për këto marrëveshje të rëndësishme të qirave janë përcaktuar në bazë të angazhimeve të pa anulueshme në bazë të kontratës. Banka ka siguruar se kontratat për qira kanë klauzola mbrojtëse, të paktën 60 ditë për rastet e përfundimit të papritur të qirave. Nuk ka ndonjë kufizim që është i vendosur sipas marrëveshjeve të qirave që do të kishte një ndikim në detyrimin për qira.

Një shpalosje e mëtejshme në lidhje me marrëveshjet e qirasë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është dhënë më poshtë:

31 dhjetor 2019

Dega	Shuma e qirasë operative	Baza për tatim	Tatimi në qira	Shuma minimale e pagesës	Nënqiratë	Detyrimi kontigjent
Dega e Prishtinës	395	348	31	395	85	310
Dega e Gjakovës	47	41	4	47	2	45
Dega e Pejës	96	88	8	96	22	74
Dega e Prizrenit	41	42	4	41	14	27
Dega e Mitrovicës	53	53	5	53	2	51
Dega e Gjilanit	87	77	7	87	42	45
Dega e Ferizajit	68	66	6	68	18	50
Zyra Qendrore	83	71	6	83	47	36
Gjithsej	870	786	71	870	232	638

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

24. Zotime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

31 dhjetor 2018

Dega	Shuma e qirasë operative	Baza për tatim	Tatimi në qira	Shuma minimale e pagesës	Nënqiratë	Detyrimi kontigjent
Dega e Prishtinës	320	289	26	320	51	269
Dega e Gjakovës	49	33	3	49	2	47
Dega e Pejës	95	89	8	95	13	82
Dega e Prizrenit	43	44	4	43	13	30
Dega e Mitrovicës	54	56	5	54	3	51
Dega e Gjilanit	92	78	7	92	37	55
Dega e Ferizajit	63	56	5	63	10	53
Zyra Qendrore	90	78	7	90	36	54
Gjithsej	806	723	65	806	165	641

Çështjet gjyqësore

Më 31 dhjetor 2019, ka procedura ligjore të caktuara kundër Bankës. Banka ka paguar shumën prej 90 mijë euro (31 Dhjetor 2018: 62 mijë euro) lidhur me procedurat ligjore në datën e raportimit. Veprime të ndryshme ligjore dhe pretendime mund të pohohen në të ardhmen kundër Bankës nga proceset gjyqësore dhe pretendimet që ndodhin në rrjedhën normale të biznesit. Rreziqet e ngjashme janë analizuar nga menaxhmenti sa i përket gjasave të ndodhjes. Megjithatë rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të konstatohet gjithnjë me saktësi, menaxhmenti beson se nuk ka mundësi që të dalin detyrime materiale shtesë.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

25. Transaksionet me palët e lidhura

Në përputhje me SNK 24 "Shpalosjet e Palëve të Ndërlidhura", një palë e lidhur është çdo palë që ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Transaksionet e palëve të ndërlidhura janë bërë në kushte të barasvlershme me ato që mbizotërojnë në transaksionet e krahut.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj bankare, Banka ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe balanecat me aksionerët dhe personat dhe subjektet e lidhur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesorë dhe palët tjera të lidhura me ta		Totali	
	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018
<i>Kredi dhënë klientëve</i>	-	-	187	187	3,496	4,014	3,683	4,201
Kreditë dhënë klientëve, bruto Parapagimet – BV					1,156	1,156		
Zbritje për zhvlerësim	-	-	(2)	(2)	(15)	(16)	(17)	(18)
Kreditë dhënë klientëve, neto	-	-	185	185	4,638	3,998	4,823	4,183
Kolateral në mjete monetare	-	-	(519)	(396)	(12,488)	(13,843)	(13,007)	(14,239)
Ekspozimi neto	-	-	(334)	(211)	(7,851)	(9,845)	(8,185)	(10,056)
Garancitë	-	-	-	-	174	112	174	112
Kolaterali në mjete monetare	-	-	-	-	(215)	(1,782)	(215)	(1,782)
Ekspozimi neto	-	-	-	-	(41)	(1,669)	(41)	(1,670)
Depozita të klientëve	16	72	98	108	12,570	16,207	12,683	16,387
Borxhi i varur	-	-	-	-	1,050	1,050	1,050	1,050

Vlera totale e vlerësuar e kolateralit duke llogaritur edhe garancionet, përfutur nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 ishte 19,762,386 euro. Në 31 dhjetor 2018 vlera e tillë e vlerësuar ishte 15,817,445 euro.

Angazhimet e papërdorura për kredi me palët e lidhura më 31 dhjetor 201, janë 629,275 euro (2018: 350,180 euro).

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

24. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Depozitat e palëve të lidhura përbëjnë 4.5 % (2018: 6.6%) të gjendjes totale të depozitave të klientëve.

Transaksionet me palët e lidhura gjatë 2019 dhe 2018 janë si në vijim:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesorë dhe palët e tjera të lidhura me ta		Totali	
	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018
Të ardhura nga interesi	-	-	8	7	193	232	201	239
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	-	-	-	-	31	34	32	34
Shpenzime interesi	-	-	-	-	(230)	(239)	(230)	(239)
Shpenzimet e implementimit-BV					(356)	(356)		

Shpërblimi total për drejtuesit kryesorë të Bankës është si në vijim:

	2019	2018
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për Bordin Drejtues	71	73
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për drejtuesit kryesor	205	223
	276	296

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Menaxhimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje dhe pamje e përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i tregut
- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit rrezik më sipër, objektivave, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe menaxhimin e kapitalit të saj.

Banka ka kategoritë e mëposhtme të instrumenteve financiare:

- pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, duke treguar veçmas (i) ato të përcaktuara si të tilla pas njohjes fillestare dhe (ii) ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim në përputhje me SNK 39;
- investimet e mbajtura deri në maturim;
- kreditë dhe të arkëtueshmet;
- pasuritë financiare në gjendje për shitje;
- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke treguar veçmas (i) ato të përcaktuara si të tilla me njohjen fillestare dhe (ii) ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim në përputhje me SNK 39; dhe
- detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar

Kuadri për menaxhimin e rrezikut

Bordi i Drejtorëve (“Bordi”) ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Pasurive dhe Detyrimeve (“ALCO”), Komitetin e Likuiditetit, Komitetin e Kredive, Komitetin e Auditimit, dhe Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të Bankës mbi menaxhimin e rrezikut në fushat e tyre specifike. Të gjitha Komitetet kanë anëtar ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtimit për aktivitetet e tyre.

Politikat e Bankës për menaxhimin e riskut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Banka, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Hyrje dhe pamje e përgjithshme (vazhdim)

Banka synon të zhvillojë një mjedis konstruktiv kontrolli, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrat e tyre.

Komiteti i Auditimit i Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputshmërisë me politikat dhe procedurat e Bankës për menaxhimin e rrezikut dhe për shqyrtimin e përshtatshmërisë së kuadrit të menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet me të cilat ballafaqohet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës ndihmohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr rishikime të rregullta dhe ad-hoc të kontrolleve dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, rezultatet e të cilave raportohen në Komitetin e Auditimit.

Banka vepron në kushtet e një krize financiare globale dhe ekonomike në zhvillim dinamik. Zgjerimi i mëtejshëm i saj mund të rezultojë në implikime negative në pozitën financiare të Bankës. Menaxhmenti i Bankës kryen monitorim ditor për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe zhvillimin e tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon rentabilitetin, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe zbaton masat adekuate në lidhje me kredinë, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, Banka përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut, duke ruajtur një pozicion të përshtatshëm kapital dhe likuid.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Bankës nëse një klient ose kundërparti e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me kredi dhe paradhënie ndaj klientëve dhe bankave të tjera. Për qëllime të raportimit financiar Banka merr në konsideratë dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (rreziku i mospagës të huamarrësit individual, rreziku i vendit dhe rreziku i sektorit).

Manaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë përgjegjësinë për monitorimin e rrezikut të kredisë.

Një departament i veçantë i Rrezikut Kreditor është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut kreditor të bankës.

Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë për huamarrësit nga Komiteti i Rrezikut kryhet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë së huamarrësit. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë gjithashtu menaxhohet pjesërisht duke përfutur kolateral dhe garanci.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat më poshtë paraqesin informacione mbi cilësinë kreditore të pasurive financiare dhe zbritjet për zhvlerësime/humbje krijuar nga Banka kundrejt këtyre pasurive.

Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë për Bankën më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, pa marrë në konsideratë ndonjë kolateral të mbajtur ose mbrojtje të tjera ndaj rrezikut të kredisë, të bashkëngjitura. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu siç është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar

	Kreditë dhënë klientëve		Investimet në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018
<i>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë</i>								
Vlera e bartur	208,570	170,721	35,101	25,496	56,007	68,035	-	-
Shuma e angazhuar/garantuar	15,811	13,293	-	-	-	-	2,154	3,757
	224,381	184,014	35,101	25,496	56,007	68,035	2,154	3,757
<i>Me kosto të amortizuar</i>								
Standarde	204,039	167,080	35,101	25,496	56,007	68,035	-	-
Në vrojtim	5,501	4,325	-	-	-	-	-	-
Nënstandarde	1,190	863	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta	1,328	1,674	-	-	-	-	-	-
Të humbura	3,656	4,217	-	-	-	-	-	-
Totali	215,714	178,159	35,101	25,496	56,007	68,035	-	-
Zbritja për zhvlerësim (individual dhe në grup)	(7,144)	(7,438)	-	-	-	-	-	-
Vlera kontabël neto	208,570	170,721	35,101	25,496	56,007	68,035	-	-
<i>Zëra jashtë bilancit: ekspozimi maksimal</i>								
Garanci financiare: rrezik i ulët/i pranueshëm	15,811	13,293	-	-	-	-	2,154	3,757
Angazhime/garanci totale	15,811	13,293	-	-	-	-	2,154	3,757
Provizionet e njohura si detyrim			-	-	-	-	(28)	(19)
Ekspozimi total	15,811	13,293	-	-	-	-	2,127	3,738

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

	2019				2018			
	Individë	Mikro	Korporata	Totali i kredive	Individë	Mikro	Korporata	Totali i kredive
Kredi dhe paradhënie klientëve								
Shuma bruto totale	80,117	55,292	80,306	215,714	68,944	29,383	79,382	178,159
Zbritje për zhvlerësim (individuale dhe kolektive)	(1,914)	(2,685)	(2,546)	(7,144)	(1,893)	(1,528)	(4,017)	(7,438)
Vlera kontabël neto	78,203	52,607	77,760	208,570	67,051	27,855	75,815	170,721
Me kosto të amortizuar								
Standarde	77,465	50,811	75,763	204,039	66,793	27,059	73,228	167,080
Në vrojtim	1,363	1,794	2,344	5,501	792	720	2,813	4,325
Nënstandarde	189	382	618	1,190	113	325	425	863
Të dyshimta	352	674	302	1,328	376	308	990	1,674
Të humbura	747	1,630	1,279	3,656	870	971	2,376	4,217
Totali Bruto	80,117	55,292	80,306	215,714	68,944	29,383	79,832	178,159
Minus: zbritje për kredi të zhvlerësuar individualisht	(964)	(2,048)	(1,386)	(4,398)	(1,085)	(1,193)	(2,953)	(5,231)
Minus: zbritje për kredi të zhvlerësuar në grup	(950)	(637)	(1,159)	(2,746)	(808)	(335)	(1,064)	(2,207)
Totali i zbritjes për zhvlerësim	(1,914)	(2,685)	(2,546)	(7,144)	(1,893)	(1,528)	(4,017)	(7,438)
Kredi me kushte të rinegociuara								
Vlera kontabël	299	1,296	2,256	3,851	318	456	4,022	4,796
Zbritje për zhvlerësim	(83)	(763)	(484)	(1,330)	(99)	(208)	(1,877)	(2,184)
Vlera e kontabël neto	216	533	1,772	2,521	219	248	2,145	2,612
Kredi në vonesë								
Jo në vonesë	75,715	48,277	72,558	196,550	65,287	25,609	70,919	161,815
Në vonesa 1 - 30 ditë	2,115	3,404	5,080	10,599	1,966	1,690	5,120	8,776
Në vonesa 31 - 90 ditë	1,434	1,762	1,131	4,326	761	889	1,848	3,498
Në vonesa 91 - 365 ditë	381	672	768	1,822	442	790	1,425	2,657
Në vonesa mbi 365 ditë	471	1,177	768	2,416	488	405	520	1,413
	80,116	55,292	80,306	215,714	68,944	29,383	79,832	178,159

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Zhvlerësime dhe provizionime

Provizionet totale që kërkohen nga Rregullorja e BQK për “Menaxhimin e Rrezikut të kredisë” (shih 3.(f)(vii)) përfshijnë humbje të ndodhura/pësuara në datën e raportimit (“modeli i humbjeve të shkaktuara”) dhe humbjet e pritshme.

Banka vlerëson probabilitetin e dështimit në pagim të kundërparive, duke përdorur mjete të brendshme rankimi/renditje të përshtatshme për kategori të ndryshme kundërpartish. Mjete të tilla kombinojnë analizën dhe gjykimin dhe janë të vlefshme, kur është e përshtatshme, duke u krahasuar me të dhëna të jashtme të disponueshme.

Kundërpartitë janë segmentuar në pesë kategori dhe klasifikimi i Bankës, i cili është treguar më poshtë, reflekton intervalin e probabilitetit të dështimit, të përcaktuar për çdo kategori. Ekspozimet lëvizin midis kategorive kur vlerësimi i i probabilitetit të dështimit ndryshon. Mjetet e rankimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, përmirësohen dhe validohen nga Banka.

Kreditë janë rankuar/renditur nga A në E në sistemin e brendshëm të rankimit të rrezikut të kredisë:

- A Standarde
- B Në vrojtim
- C Nënstandarde
- D Të dyshimta
- E Të humbura

Banka raporton klasifikimin e humarrësve të saj, tek BQK dhe Regjistri i Kredisë së Kosëvës. Politika e provizionimit për këto kredi është detajuar në shënimin 3.(f) (vii).

Vlerësimet individuale dhe kolektive të portofolit të kredisë

Për qëllime të manaxhimit të brendshëm, Banka veçon kreditë në kredi që vlerësohen individualisht për zhvlerësim: këto janë kredi të klasifikuara si nënstandarte ose më ulët. Të gjitha kreditë e tjera analizohen kolektivisht/në grup për qëllime të vlerësimit për zhvlerësim.

Politika e Bankës kërkon rishikimin e kredive individuale dhe paradhënies ndaj klientëve të cilat janë mbi kufijtë e materialitetit prej 50 mijë euro (2019: 50 mijë euro) së paku në baza tremujore kur rrethanat individuale e kërkojnë këtë gjë.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kredi në vonesë por të pazhvlerësuara

Kredive dhe letrave me vlerë, të cilave u ka kaluar afati, por nuk janë zhvlerësuar janë ato kredi, ku interesit kontraktual ose pagesave të principalit ju ka kaluar afati, por Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do të bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Politika e fshirjes

Banka fshin një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi i fshirjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total. Shuma totale e fshirë gjatë vitit 2019, ishte 1,593 mijë euro (2018: 2,434 mijë euro).

Depozita në banka

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i rrezikut dhe i menaxhimit kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's.

Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim total të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalojnë 15% të kapitalit rregullator të nivelit të parë.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Më 31 dhjetor	2019	2018
AAA+ deri në BBB-	6,143	4,936
A+ deri në A-	183	177
BB+ deri në B-	-	54
BBB+ deri në B-	613	447
Jo të rankuara	376	192
Bankat Lokale	6,848	6,360
	14,163	12,166

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Zotimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shumta e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për zotimet e kreditimit është shumta e plotë e zotimit.

Politikat e zbutjes dhe kontrollit të limiteve të rrezikut

Banka menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e riskut të kredisë kudo që ata janë të identifikuar në mënyrë të veçantë kundrejt palëve individuale dhe grupeve, dhe palëve të tjera të lidhura.

Banka strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politikat e zbutjes dhe kontrollit të limiteve të rrezikut

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Banka mban kolateral kundrejt kredive dhe paradhënies ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi pasuri të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi dhe paradhënie ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

	2019		2018	
	Kreditë dhe paradhënie klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit	Kreditë dhe paradhënie klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit
Hipoteka	57,982	54,467	48,012	45,128
Kolateral në mjete monetare	2,402	2,401	3,837	3,686
Pengje	98,134	72,757	81,434	60,532
Miks (hipotekë dhe peng)	50,731	48,868	39,132	37,037
Pa kolateral	6,465	-	5,744	-
Totali	215,714	178,493	178,159	146,383

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Më 31 dhjetor 2019, Banka ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të pare. Ekspozimi më i lartë ishte në: 10.19% (2018: Banka nuk ka pasur asnjë ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të pare. Ekspozimi më i lartë ishte në 8,30%). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019, përfaqëson 14.38% (2018: 16.87%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 7.71% (2018: 11.83%) të kapitali të nivelit të parë.

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kreditë klientëve		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018
Përqendrimi sipas sektorëve								
Korporata	77,760	75,814	-	-	-	-	1,499	3,193
Qeveria	-	-	35,101	25,496	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	56,007	68,035	-	-
Individët	78,203	67,051	-	-	-	-	-	-
Mikro bizneset	52,607	27,856	-	-	-	-	655	564
Totali	208,570	170,721	35,101	25,496	56,007	68,035	2,154	3,757
Përqendrimi sipas vendndodhjes								
Vendet e BE	-	-	-	-	6,318	5,629	-	-
Republika e Kosovës	208,570	170,721	35,101	25,496	49,689	62,406	2,154	3,757
Totali	208,570	170,721	35,101	25,496	56,007	68,035	2,154	3,757

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që flukset monetare të ardhshme do të luhaten nga ndryshimet e normës së interesit të tregut dhe rreziku që maturiteti i pasurive interesprurëse ndryshon nga maturiteti i detyrimeve interesmbartëse të përdorura për të financuar këto pasuri. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar, tregon se deri në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat e konsumatorëve kanë norma fikse interesi.

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që pasuritë dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme. Banka përpiqet të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të pasurive dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me heët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Bankës në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

Departamenti i Rrezikut në një bazë të vazhdueshme monitoron rrezikun e normave të interesit përmes monitorimit të kushteve të tregut dhe duke marrë vendime të nevojshme të ri-çmimit ose rialokimit me miratimin e Komitetit të Pasurive dhe Detyrimeve. Një raport në lidhje me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komiteti të Pasurive dhe Detyrimeve. Masat e nevojshme merren nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analizë mbi depozituesit e mëdhenjë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet dhe analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analiza të rrezikut të likuiditetit, etj.

Ekspozimi ndaj normave të interesit

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që pasuritë që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e pasurive dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e rëqimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të pasurive dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të pasurive. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim) Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si në vijim:

Pasuritë	USD		EUR		CHF	
	2019	2018	2019	2018	2019	2018
Paraja e gatshme dhe në banka	1.17	0.31	(0.2)	(0.16)	(1.78)	0.29
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	-	-	(0.6)	(0.40)	-	-
Kredi për klientët	-	-	7.41	7.97	-	-
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	3.21	3.21	-	-
Investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	0.03	1.11	-	-
Detyrimet		-		-	-	-
Depozita të klientëve	0.28	0.28	0.86	0.93	-	-
Borxhi i varur	-	-	7.5	7.50	-	-

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në lakoren e pëqindjeve dhe një pozitë financiare të qëndrueshme) është si vijon:

Efekti i vlerësuar i fitimit (humbjes)	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
2019	(46)	28	190	(200)
2018	(45)	32	169	(173)

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së maturimit:

31 dhjetor 2019	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Jo interes mbartëse	Totali
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	-	-	-	-	-	-	24,309	24,309
Gjendja me BQK	41,844	-	-	-	-	-	-	41,844
Investimet në letra me vlerë - norma fikse	-	5,016	2,004	11,052	17,029	-	-	35,101
Kredi klientëve - norma fikse	2,666	6,700	10,415	18,928	117,389	52,472	-	208,570
Pasuri të tjera	-	-	-	-	-	-	685	685
Totali	44,510	11,716	12,419	29,980	134,418	52,472	24,994	310,509
Detyrimet								
Depozita të klientëve - norma fikse	152,011	11,256	6,716	32,153	80,408	138	-	282,682
Depozita të bankave	2,100	-	-	-	-	-	-	2,100
Borxh i varur - norma fikse	-	-	1,050	-	-	-	-	1,050
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	2,978	2,978
Totali	154,111	11,256	7,766	32,153	80,408	138	2,978	288,811
Hendeku	(109,602)	460	4,653	(2,173)	54,010	52,334	22,016	21,698
Hendeku kumulativ	(109,602)	(109,142)	(104,490)	(106,662)	(52,652)	(318)	21,698	

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2018	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Jo interes mbartëse	Totali
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	5,754	-	-	-	-	-	15,005	20,759
Gjendja me BQK	55,869	-	-	-	-	-	-	55,869
Investimet në letra me vlerë - norma fikse	-	5,517	751	501	18,727	-	-	25,496
Kredi klientëve - norma fikse	2,902	4,085	8,833	16,971	85,543	52,387	-	170,721
Pasuri të tjera	-	-	-	-	-	-	744	744
Totali	64,525	9,602	9,584	17,472	104,270	52,387	15,749	273,589
Detyrimet								
Depozita të klientëve - norma fikse	124,962	4,637	8,244	37,262	73,076	-	-	248,181
Depozita të bankave	2,091	-	-	-	-	-	-	2,091
Borxh i varur - norma fikse	-	-	-	-	1,050	-	-	1,050
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	283	283
Totali	127,053	4,637	8,244	37,262	74,126	-	283	251,605
Hendeku	(62,528)	4,965	1,340	(19,790)	30,144	52,387	15,466	21,984
Hendeku kumulativ	(62,528)	(57,563)	(56,223)	(76,013)	(45,869)	(6,518)	21,984	-

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës (vazhdim)

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Banka sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë monedha të huaja me kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra. Rreziku i monedhës së huaj nuk është i rëndësishëm, meqë pjesa më e madhe e transaksioneve të Bankës janë në monedhën vendase. Monedhat e huaja me të cilat Banka operon janë Dollari Amerikan (USD) Franga Zvicerane (CHF). Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si në vijim:

Valuta	2019 Euro	2018 Euro
1 USD	1.1234	1.145
1 CHF	1.0854	1.1269
1 GBP	0.8508	0.8945

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në kursin e këmbimit është si në vijim:

	USD		CHF		GBP	
	2019	2018	2019	2018	2019	2018
Ndjeshmëria ndaj kursit	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitim ose humbje						
+5% Euro	0.35	(0.20)	0.13	0.15	0.12	0.25
- 5% Euro	(0.35)	0.20	(0.13)	(0.15)	(0.12)	(0.25)

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave të huaj, i shprehur në ekuivalentë të Euro-s është si në vijim:

31 dhjetor 2019	EUR	USD	CHF	GBP	Totali
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	16,895	2,030	5,046	338	24,309
Gjendja me BQK	41,844	-	-	-	41,844
Investimet në letra me vlerë	35,101	-	-	-	35,101
Kredi klientëve	208,570	-	-	-	208,570
Pasuri të tjera	685	-	-	-	685
	303,095	2,030	5,046	338	310,509
Detyrimet					
Depozita të klientëve	275,280	2,023	5,043	336	282,682
Depozita të bankave	2,100	-	0.40	-	2,100
Borxhi i varur	1,050	-	-	-	1,050
Detyrime të tjera	2,978	-	-	-	2,978
	281,408	2,023	5,043	336	288,811
Pozicioni neto në valutë të huaj	21,687	7	3	2	21,698
31 dhjetor 2018	EUR	USD	CHF	GBP	Totali
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	13,618	2,622	4,200	319	20,759
Gjendja me BQK	55,869	-	-	-	55,869
Investimet në letra me vlerë	25,496	-	-	-	25,496
Kredi klientëve	170,721	-	-	-	170,721
Pasuri të tjera	744	-	-	-	744
	266,448	2,622	4,200	319	273,589
Detyrimet					
Depozita të klientëve	241,044	2,626	4,197	314	248,181
Depozita të bankave	2,091	-	-	-	2,091
Borxhi i varur	1,050	-	-	-	1,050
Detyrime të tjera	283	-	-	-	283
	244,468	2,626	4,197	314	251,606
Pozicioni neto në valutë të huaj	21,981	(4)	3	5	21,984

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë më në gjendje të përmbushë detyrimet e saj nga detyrimet financiare.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Bankës.

Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mblidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar.

Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Banka përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Për më tepër Banka mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara të detyrimeve financiare të Bankës në bazë të maturiteti kontraktual më të hershëm të mundshëm. Banka pret që flukset monetare të këtyre instrumenteve të ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme nga analiza. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes.

31 dhjetor 2019	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	24,309	-	-	-	-	-	24,309
Gjendja me BQK	41,844	-	-	-	-	-	41,844
Investimet në letra me vlerë	-	5,016	2,004	11,052	17,029	-	35,101
Kredi klientëve	2,666	6,700	10,415	18,928	117,389	52,472	208,570
Pasuri të tjera	685	-	-	-	-	-	685
Total	69,504	11,716	12,419	29,981	134,418	52,472	310,509
Detyrimet							
Depozita të klientëve	152,011	11,256	6,716	32,153	80,408	138	282,682
Depozita të bankave	2,100	-	-	-	-	-	2,100
Borxhi i varur	-	-	1,050	-	-	-	1,050
Detyrime të tjera	372	150	223	217	2,016	-	2,978
Totali	154,484	11,406	7,989	32,370	82,424	138	288,811
Hendeku	-84,980	310	4,430	-2,389	51,994	52,334	21,698
Hendeku kumulativ	-84,980	-84,670	-80,241	-82,630	-30,636	21,698	

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2018	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Me maturitet të pacaktuar	Totali
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	20,759	-	-	-	-	-	-	20,759
Gjendja me BQK	55,869	-	-	-	-	-	-	55,869
Investimet në letra me vlerë	-	5,517	751	501	18,727	-	-	25,496
Kredi klientëve	2,902	4,085	8,833	16,971	85,543	52,387	-	170,721
Pasuri të tjera	744	-	-	-	-	-	-	744
Total	80,274	9,602	9,584	17,472	104,270	52,387	-	273,589
Detyrimet								
Depozita të klientëve	124,962	4,637	8,244	37,262	73,076	-	-	248,181
Depozita të bankave	2,091	-	-	-	-	-	-	2,091
Borxhi i varur	-	-	-	-	1,050	-	-	1,050
Detyrime të tjera	283	-	-	-	-	-	-	283
Totali	127,336	4,637	8,244	37,262	74,126	-	-	251,605
Hendeku	(47,062)	4,964	1,340	(19,790)	30,146	52,387	-	21,985
Hendeku kumulativ	(47,062)	(42,098)	(40,758)	(60,548)	(30,402)	21,985	21,985	-

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Manaxhimi i rrezikut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vet për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes përmirësimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet nga kapitali i aksionar, rezervat dhe fitimi i pashpërndarë.

Kapitali rregullator

Banka monitoron adekuatshmërinë e kapitalit duke përdorur ndër masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj pasurive të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Adekuatshmërisë së Kapitalit është 8% për Kapitalin e Nivelit të Parë dhe 12% për totalin e fondeve të veta.

Pasuritë e peshuara me rrezikun (APR-të)

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke iu caktuar një peshë rreziku në përputhje me shumën e vlerësuar të kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i mbështetur ato. Zbatohen gjashtë kategori të peshimit të rrezikut: (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, dhe 150%): për shembull instrumentet e tregut të parasë peshohen me rrezik 0%, i cili nënkupton që nuk nevojitet kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre pasurive. Pasuri afatgjata materiale peshohen me rrezik 100% çka nënkupton që ato duhet të mbështeten nga Kapital i Nivelit të Parë në shkallën 8% të vlerës kontabël. Angazhimet jashtë bilancit të lidhura me kreditimin merren në konsideratë. Shumat më pas peshohen me rrezikun duke përdorur përqindje të njëjtë me atë të pasurive të bilancit.

	2019	2018
Pasuritë totale të peshuara me rrezik	216,022	174,797
Pasuritë totale të peshuar me rrezik për rrezikun operacional	18,668	17,127
Totali	234,690	191,924
Kapitali rregullator (Totali i kapitalit)	33,789	29,860
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (Totali i kapitalit)	14.40%	15.56%

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Manaxhimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)

Leva financiare

Komiteti i manaxhimit të rrezikut të Bankës rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsiderat koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 7%.

Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2019	2018
Gjithsej Pasuritë	322,501	281,113
Gjithsej ekuiteti cdhe rezervat	33,446	29,361
Raporti i levës	10.37%	10.44%

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EURO, përveç nëse shprehet ndryshe)

27. Ngjarjet pasuese

Në Dhjetor 2019, një lloj storie i koronavirusit u raportua në Wuhan, Kinë. Organizata Botërore e Shëndetit ka deklaruar shpërthimin për të krijuar një "Urgjencë të Shëndetit Publik të Brengave Ndërkombëtare". Përhapja e COVID-19 po prish zinxhirët e furnizimit dhe po prek prodhimin dhe shitjet në një gamë të industrive. Shkalla e ndikimit të COVID-19 në performancën tonë operacionale dhe financiare do të varet nga zhvillime të caktuara, përfshirë kohëzgjatjen dhe përhapjen e shpërthimit, ndikimin tek klientët tanë, punonjësit dhe shitësit të gjitha këto janë të pasigurta dhe nuk mund të parashikohen.

Ndikimi në bankë

Në këtë pikë, masa në të cilën COVID-19 mund të ndikojë në pozicionin tonë financiar dhe rezultatet e operacioneve është e pasigurt, sipas vlerësimit tonë aktual, banka do të përballet me uljen e të ardhurave neto nga interesi dhe ulje të tarifave dhe të ardhurave nga komisioni. Bazuar në situatën aktuale dhe zhvillimin aktual, banka do të ruajë kërkesat e saj ligjore të kapitalit dhe kërkesat e nivelit të likuiditetit.

Banka ka përcaktuar që këto ngjarje nuk janë rregulluese të ngjarjeve pasuese. Në përputhje me rrethanat, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve nga dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019 nuk janë rregulluar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të Qeverisë dhe Bankës Qendrore, mbetet e paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e bankës për periudhën e ardhshme.

Banka po monitoron çdo ditë pozicionin e saj të likuiditetit dhe raporton në Bankën Qendrore të Kosovës. Pozicioni ynë aktual i likuiditetit është i favorshëm për t'u marrë me krizën aktuale dhe nuk presim që të kemi ndonjë vështirësi të likuiditetit gjatë krizës.

Bazuar në të dhënat aktuale dhe zhvillimet aktuale në terren, banka vazhdon të jetë mbi kërkesat e kapitalit dhe kërkesat e nivelit të likuiditetit. Banka vazhdon të ofrojë të gjitha shërbimet e rregullta për klientët dhe biznesin e saj si zakonisht në të gjithë praninë e saj fizike në të gjithë Kosovën.

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit, përveç atyre të mësipërme, që mund të kërkojnë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.



www.bekonomike.com